

# Vlerësim për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri



United Nations  
ALBANIA



International Organization for Migration



SWEDEN



# Vlerësim për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri

**Raport**

**Qershor 2016**

Përgatitur për Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin  
nga Kosta Barjaba, Konsulent.

Ky botim është realizuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM) nën projektin "Nxitja e mundësive të përshtatshme për punësim dhe mbrojtjes së punëtorëve migrantë në Shqipëri", në kuadër të Programit të Bashkëpunimit 2012-2016, me mbështetjen financiare të Qeverisë Suedeze, përmes Fondit të Koherencës së "Një OKB".

Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin, të OKB-së në Shqipëri ose Qeverisë Suedeze.

IOM-i është e përkushtuar ndaj parimit se, migracioni njerëzor dhe i rregullt, është në dobi të migrantëve dhe shoqërisë. Si një organizatë ndërqeveritare, IOM-i bashkëpunon me partnerët e saj në komunitetin ndërkombëtar dhe kombëtar, për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve aktuale të migracionit; për të rritur nivelin e kuptimit e çështjeve të migracionit; inkurajuar zhvillimin social dhe ekonomik nëpërmjet migracionit dhe për të mbrojtur dinjitetin njerëzor dhe mirëqenien e migrantëve.

Raporti aktual është publikuar pa editimin formal nga ONM.

Botues: Organizata Ndërkombëtare për Migracionin

Misioni në Shqipëri

Rruga "Ibrahim Rugova", Nd. 42, H. 12, Apt. 4 Tirana, Albania

Tel: +355 42257836

Fax: +355 4225 7835

E-mail: [infotirana@iom.int](mailto:infotirana@iom.int)

Internet: <http://www.albania.iom.int>

© 2016 Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të ruajtjes, apo të transmetohet në çdo formë ose me çdo mjet, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar, ose ndryshe pa lejen paraprake me shkrim të botuesit.

# PËRMBAJTJA

Hyrja.....	5
Përmbledhja.....	6

## I

### Konventat ndërkombëtare për zbatimin e të drejtave të Punëtorëve Migrantë

1.1. Konventat e OKB-së.....	10
1.2. Konventat e ILO-s.....	13
1.3. Politikat dhe standardet e Këshillit të Europës.....	15
1.4. Politikat dhe standardet e Bashkimit Europian.....	17
1.4.1. Konventat e BE-së.....	17
1.4.2. Politikat aktuale të BE-së për migrimin.....	17

## II

### Legjislacioni Kombëtar për Zbatimin e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë

2.1. Kushtetuta e Shqipërisë.....	19
2.2. Legjislacioni primar.....	19
2.3. Legjislacioni sekondar.....	24
2.4. Kuadri rregullator.....	25
2.5. Procedurat dhe standardet operacionale.....	26

## III

### Boshllëqet midis Konventave Ndërkombëtare dhe Kornizës Kombëtare

3.1. Boshllëqet e politikave.....	29
3.2. Boshllëqet e legjislacionit.....	31
3.3. Boshllëqet institucionale.....	33

## IV

### Korniza institucionale dhe kapacitetet për monitorimin e mbrojtjes së të drejtave dhe aksesit në të Drejtat e Punëtorëve Migrantë

4.1. Korniza institucionale.....	34
4.2. Mekanizmat e monitorimit.....	35
4.2.1. Mekanizmat ndërkombëtarë të monitorimit.....	35
4.2.2. Mekanizmat kombëtare të monitorimit.....	36
4.3. Institucionet e monitorimit.....	37

## V

### Sfidat e Zbatimit/Shkelja e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri

5.1. Mungesa e mekanizmave efektive për të monitoruar të drejtat e migrantëve në Shqipëri. ....	39
5.2. Konsiderata të përgjithshme mbi gjendjen e të drejtave të migrantëve.....	39
5.3. Të drejtat në punë. ....	40
5.4. Aksesit në shërbimet publike. ....	41
5.5. Trajtimi i migrantëve që hyjnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt.....	43
5.6. Aksesit në sistemin e drejtësisë.....	45
5.7. Trajtimi në institucionet penitenciare. ....	47
5.8. E drejta e familjarëve për të ruajtur leje-qëndrimin. ....	48

## VI

### Gjetjet dhe Rekomandimet

6.1. Gjetjet. ....	49
6.2. Rekomandimet.....	52

<b>Bibliografia dhe Burimet.....</b>	<b>55</b>
--------------------------------------	-----------

# Hyrje

Ky raport "Vlerësim për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri", u përgatit në kuadër të projektit "Nxitja e mundësive të përshtatshme për punësim dhe mbrojtjes së punëtorëve migrantë në Shqipëri", financuar nga Qeveria Suedeze, përmes Fondit të Koherencës së "Një OKB" dhe zbatohet nga ONM Tirana (Shqipëri) në partneritet me Qeverinë Shqiptare.

Gjatë përgatitjes së raportit, u konsultuan konventat ndërkombëtare për punëtorët migrantë, të drejtat e grave migrante dhe çështje të tjera të ndërlidhura; me legjislacionin e Shqipërisë dhe kuadrin rregullator mbi migracionin, të drejtat e punëtorëve migrantë dhe migrantëve në Shqipëri, me fokus të veçantë në të drejtat e grave; u takuan dhe u diskutua me disa aktorë kyç; dhe u zhvilluan intervista individuale dhe fokus grupe me palët e interesuara dhe migrantët në Shqipëri. Gjithashtu, konsulenti diskutoi me disa përfaqësues nga institucionet përkatëse që trajtojnë çështje të migracionit në vend, të tilla si Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtorët e Përgjithshëm të Burgjeve, Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Inspektoriatit Shtetëror të Punës, Gjykata e Tiranës, Gjykata Administrative në Tiranë, Gjykatës së Lartë, Prokurorisë së Tiranës, Avokatit të Popullit të Shqipërisë, Komitetit shqiptar të Helsinkit, etj.

Raporti përbëhet nga gjashtë pjesë:

Pjesa e parë prezanton konventat kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të punëtorëve migrantë për të dhënë kontekstin.

Pjesa e dytë analizon legjislacionin e Shqipërisë për zbatimin e të drejtave të punëtorëve migrantë, duke u fokusuar në legjislacionin parësor dhe dytësor, si edhe kornizën rregullatore dhe standardet dhe procedurat e punësimit, të qëndrimit dhe integritit të punëtorëve migrantë në Shqipëri.

Pjesa e tretë shqyrton mangësitë midis konventave ndërkombëtare dhe kornizës kombëtare të rregulloreve të punëtorëve migrantë në Shqipëri, me fokus të veçantë në mangësitë e legjislacionit, mangësitë e politikave dhe mangësitë institucionale.

Pjesa e katërt shqyrton kornizën institucionale dhe kapacitetet për monitorimin e mbrojtjes së të drejtave dhe aksesin në të drejtat e punëtorët migrantë, me fokus të veçantë në kuadrin institucional, instrumentet e monitorimit dhe institucionet e monitorimit.

Pjesa e pestë shqyrton çështjet e implementimit dhe shkeljes së të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri.

Pjesa e gjashtë jep një përmbledhje të gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore.

# Përmbledhje ekzekutive

1. Raporti shqyrton zbatimin e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri dhe kapacitetet e vendit për zbatimin e këtyre të drejtave, me fokus kryesor kuadrin institucional, instrumentet dhe institucionet monitoruese.
2. Raporti shqyrton kornizën ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare të të drejtave të punëtorëve migrantë. Niveli ndërkombëtar i referohet shqyrtimit të konventave ekzistuese të OKB-së dhe ILO-s dhe mekanizmave mbrojtës, si edhe politikave dhe standardeve përkatëse të punëtorëve migrantë të Këshillit të Evropës dhe të BE-së. Niveli kombëtar përfshin shqyrtimin e kushtetutës së Shqipërisë, legjislacionit, kuadrin rregullator dhe standardeve të punës lidhur me të huajt në Shqipëri.
3. Shqipëria ka ratifikuar dhe po zbaton me sukses shumicën e konventave ndërkombëtare për punëtorët migrantë. Edhe pse njihet si vend origjine, Shqipëria ka një kuadër ligjor pothuajse të plotë për punëtorët migrantë.
4. Migrantët në Shqipëri kryesisht kategorizohen si të punësuar, vetëpunësuar dhe sipërmarrës. Numri i punëtorëve të punësuar dhe të vetëpunësuar ka rënë gjatë periudhës 2012-2014, ndërkohë që numri i sipërmarrësve është rritur.
5. Legjislacioni shqiptar favorizon hyrjen, qëndrimin, punësimin dhe studimin e të huajve në Shqipëri. Mund të themi se trajtimi i punëtorëve migrantë pasqyron kulturën tradicionale të shqiptarëve për respektimin dhe nderimin e të huajve.
6. Ka një hendek midis kënaqësisë së punëtorëve migrantë nga sjellja e qytetarëve shqiptarë dhe kënaqësisë së tyre nga shërbimet, agjencitë dhe institucionet publike. Pra, niveli i kënaqësisë që ata kanë nga qytetarët shqiptarë është më i lartë se niveli që marrin nga shërbimet publike.
7. Legjislacioni i migracionit shqiptar përgjithësisht pasqyron parimet e konventave ndërkombëtare për të drejtat e migrantëve. Megjithatë, ka ende disa boshllëqe ligjore, politike dhe institucionale në zbatimin e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri.
8. Legjislacioni i migracionit shqiptar nuk ka dispozita ligjore që trajtojnë drejtpërsëdrejti perspektivën dhe barazinë gjinore të migrantëve. Megjithatë, këto çështje janë trajtuar nga legjislacioni i vendit për marrëdhëniet ekonomike dhe të punës, të cilat zbatojnë kërkesat e konventës ndërkombëtare mbi eliminimin e diskriminimit ndaj grave. Ky studim është përpjekja e parë për të adresuar perspektivën gjinore dhe barazinë gjinore të imigrantëve.
9. Ka një mospërputhje midis adresimit të të drejtave të njeriut, të drejtave të migrantëve dhe migrantëve në vend. Ndërkohë që debatet publike dhe politike për barazinë gjinore rrallë herë përfshijnë gratë punëtore migrante në Shqipëri.
10. Boshllëqet e legjislacionit që adresojnë të drejtat e migrantëve në Shqipëri janë kryesisht të lidhura me kohën e lëshimit të lejes së qëndrimit për anëtarët e familjes; e drejta e anëtarëve të familjes për të ruajtur lejen e qëndrimit në raste divorci apo vdekjeje të një punëtori migrant; e drejta e migrantëve të parregullt për të qenë pjesë e sindikatave; mbrojtjen e migrantëve të parregullt, fëmijëve, refugjatëve dhe azilkërkuesve; pjesëmarrjen e tyre në programet e integritimit dhe ndihmës sociale dhe shërbimet, strehimin social dhe arsimin.



11. Kuadri institucional për adresimin e politikave të migracionit për qëllime punësimi në Shqipëri është si më poshtë: Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Arsimit dhe Sportit; Instituti i Statistikave dhe organizata të ndryshme ndërkombëtare, siç është Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), dhe Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara (UNICEF).
12. Boshllëqet institucionale në zbatimin e të drejtave të migrantëve në Shqipëri janë kryesisht të lidhura me faktin se institucionet dhe agjencitë shtetërore rrallë herë adresojnë të drejtat e punëtorëve migrantë; korniza ligjore dhe institucionale e të drejtave të punëtorëve migrantë nuk mbështetet nga kapacitetet e burimeve njerëzore në adresimin e këtyre çështjeve; vendi nuk ka as trashëgimi institucionale dhe as memorie institucionale në trajtimin e çështjeve të migracionit; pushteti vendor pothuajse nuk përfshihet fare në adresimin, garantimin, mbështetjen ose monitorimin e të drejtave të punëtorëve migrantë; sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve nuk tregojnë interes për mbrojtjen e punëtorëve migrantë; nuk ka institucione shtetërore që mbledhin, analizojnë, monitorojnë, ose japin informacion mbi respektimin apo shkeljen e të drejtave të migrantëve.
13. Aktualisht, Shqipëria ndjek disa mënyra për respektimin e të drejtave të punëtorëve migrantë. Këto instrumente monitoruese operohen nga një sërë organesh publike, komitetesh dhe organizatash civile. Veprimtaria e organizatave qeveritare dhe OJF-ve që lidhen me çështjet e migracionit, kanë pasur një ndikim pozitiv në respektimin e të drejtave të punëtorëve të huaj në vend. Përpjekjet e tyre kanë qenë të fokusuara në zhvillimin e legjislacionit, në mbështetjen dhe zhvillimin e Teknologjisë së Informacionit, kryerjen e sondazheve, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe zhvillimin e burimeve njerëzore që adresojnë migracionin dhe çështjet që lidhen me të.
14. Megjithatë, edhe pse Shqipëria ka aderuar në Konventën ndërkombëtare për të drejtat e punëtorëve migrantë në vitin 2007 dhe ka raportuar për këtë konventë në vitin 2009, asnjë prej këtyre organizatave as nuk ka kryer sondazhe të rregullta, as nuk ka monitoruar proceset e zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë në vend.
15. Instrumenti më i rëndësishëm i monitorimit të zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri janë raportet periodike të konventës. Qeveria e Shqipërisë raporton periodikisht për konventën e punëtorëve migrantë në lidhje me statusin e të drejtave të punëtorëve migrantë në vend. Gjithsesi, duke iu referuar raporteve të vitit 2008 dhe 2010, këto dokumenta përmbajnë informacion të përgjithshëm për të drejtat e parashikuara nga legjislacioni i vendit, dhe jo për respektimin e të drejtave.
16. Mekanizma të tjerë monitorimi janë raportet periodike të paraqitura në Komitetin për zhdukjen e diskriminimit racor (CERD), Komitetin për të drejtat e njeriut, Komitetin për zhdukjen e diskriminimit ndaj grave (CEDAW) dhe Konventës kundër torturës (CAT).
17. Raportet e Reporterit Special të OKB dhe UNHCR janë nga burimet ndërkombëtare mbi zbatimin e të drejtave të migrantëve që hyjnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt.
18. Disa nga instrumentet kombëtare për monitorimin e zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë të huaj në Shqipëri janë si vijon: inspektimet e Inspektoratit Shtetëror të Punës; Regjistri Kombëtar Elektronik për të huajt; Grupi Ndërinstitucional i punës për Profilin e Migracionit të Shqipërisë; hetimet e Avokatit të Popullit; raportet e institucioneve të zbatimit të ligjit; çështjet gjyqësore dhe raportet e OJF-ve vendase, si Komiteti Shqiptar i Helsinkit.
19. Avokati i Popullit dhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit janë përkatësisht institucioni kryesor publik and OJF-ja kryesore që monitorojnë zbatimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve

- në Shqipëri. Ka gjithashtu edhe një sërë organizatash të shoqërisë civile me fokus të veçantë tek mbrojtja e të drejtave të njeriut, e të drejtave të fëmijëve, të drejtave të të moshuarve, të drejtave të grave dhe të drejtave të pjesëve të tjera të pambrojtura të popullatës.
- 20.** Raporti përmend një sërë rastesh të ankesave për shkeljen e të drejtave të punëtorëve migrantë në vend gjatë viteve të fundit. Shumica e ankesave kishin të bënin me refuzimin e hyrjes, lëshimin e lejes së qëndrimit apo lejes së punës dhe përjashtimin nga vendi. Ankesat kanë qenë kryesisht ndaj autoriteteve rajonale të kufirit dhe migracionit apo zyrave rajonale dhe vendore të punësimit.
  - 21.** Nuk janë regjistruar ankesa nga punëtorë të huaj apo nga të huaj të vetëpunësuar në Inspektoratin Shtetëror të Punës gjatë vitit 2015.
  - 22.** Profili i Migracionit i Shqipërisë përmend se gjatë periudhës 2012-2014 rreth 18 përqind të migrantëve të parregullt, 471 nga 2,618, u është refuzuar hyrja në Shqipëri për një mori arsesh, si mungesa e dokumentave të identitetit, shkelje të mëparshme të rregullave të qëndrimit në Shqipëri, mungesë e mbështetjes financiare, pamundësia për të justifikuar qëllimin e ardhjes, etj.
  - 23.** Zbatimi i të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri has sfida të ndryshme. Pjesa më e madhe e ankesave kanë të bëjnë me të drejtat e punës, aksesin në shërbimet publike, trajtimin e migrantëve që hyjnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt, aksesin në sistemin e drejtësisë dhe trajtimin në institucionet e vuajtjes së dënimit.
  - 24.** Gjatë viteve të fundit, Raporteri Special për të drejtat ka nënvizuar nevojën për informacion të përshtatshëm për azilkërkuesit, trajtimin më të mirë për fëmijët migrantë dhe mbështetje më të mirë me përkthim për migrantët e parregullt që hyjnë në Shqipëri.
  - 25.** Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përmes tre raporteve të tij të njëpasnjëshme në 2006, 2012 dhe 2015, ka nënvizuar nevojën për rritje të kapaciteteve profesionale të policisë në pikat e kalimit kufitar; përmirësim të infrastrukturës në pikat e kalimit të kufirit; përmbushje më të mirë të nevojave kryesore të migrantëve të parregullt, si ushqim, akomodim, shërbime shëndetësore, informacion; dhe krijimi i kushteve kryesore për femrat që duhet të trajtohen nga personel policor femëror.
  - 26.** Informacioni nga Prokuroria e Tiranës tregon se shkelja e të drejtave të të huajve nuk është problem në Shqipëri. Gjatë viteve të fundit kanë qenë rreth 10 raste në muaj të ngritura nga të huajt në Shqipëri që depozitojnë çështje penale për shkelje të të drejtave apo për cenim të interesit të tyre. Çështjet e hapura nga të huajt në Prokurorinë e Rrethit Tiranë përbëjnë rreth 1 përqind të numrit të përgjithshëm të çështjeve të trajtuara.
  - 27.** Të huajt nuk përbëjnë burim të sjelljes kriminale dhe të çështjeve penale në Shqipëri. Janë rreth 60 çështje penale në vit në ngarkim të të huajve në Prokurorinë e Rrethit Tiranë. Çështjet penale në ngarkim të të huajve përbëjnë rreth 0.5 përqind të numrit të përgjithshëm të çështjeve penale në të gjithë vendin.
  - 28.** Ankesat e të huajve për trajtimin nga gjykatat konsistojnë kryesisht në dy arsye: i) shkelja e së drejtës së tyre për të pasur përkthyes gjatë të gjithë procesit; ii) kohëzgjatja e procedurave për çështjet e tyre. Gjatë vitit të fundit ambasadat e huaja në Shqipëri nuk kanë raportuar ankesa serioze nga shtetasit e tyre për shkelje të të drejtave gjatë çështjeve gjyqësore.
  - 29.** Të dënuarit e huaj trajtohen njësoj si shqiptarët. Nuk ka raste të shkeljes së të drejtave me baza etnike apo shtetësie. Shumica e të dënuarve të huaj në Shqipëri janë të dënuar për krime penale, si përfshirja në trafikun e lëndëve narkotike. Në nëntor 2015, ishin 93 të dënuar të huaj në burgjet shqiptare, shumica e tyre nga Kosova/KSKB 1244,<sup>1</sup> Italia, Maqedonia, Greqia dhe Rumania.

1 Referuar më tej si Kosova/KSKB 1244.

- 30.** Komiteti për punëtorët migrantë në sesionin e trembëdhjetë të tij më 22 nëntor-3 dhjetor 2010, nxiti Qeverinë e Shqipërisë të jepte në raportin tjetër periodik informacion për zbatimin të drejtave të punëtorëve migrantë, veçanërisht për të drejtën e pjesëtarëve të familjes për të ruajtur lejen e qëndrimit. Gjithsesi, ky rekomandim nuk u pasqyrua në legjislacionin shqiptar.
- 31.** Në përgjigje të gjetjeve dhe sfidave të identifikuara, propozohen një sërë rekomandimesh. Rekomandimet përqendrohen tek përmirësimi i zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë dhe migraanteve (femra) në Shqipëri. Sugjerohet që politikat e punësimit të të huajve në Shqipëri duhet t`u japin përparësi dhe të lehtësojnë trajtimin e punëtorëve migrantë në disa sektorë kyç të ekonomisë dhe punësimit, dhe të gërshetojnë çështjet që lidhen me punëtorët migraante femra.

# I. Konventat ndërkombëtare për zbatimin e të drejtave të punëtorëve migrantë

Ka tre burime kryesore të të drejtave ndërkombëtare: zakonet/normat ndërkombëtare, konventat ndërkombëtare, dhe parimet e përgjithshme të të drejtave ndërkombëtare të pranuar nga vendet pritëse dhe dërguese.<sup>2</sup> Ky seksion do t'u referohet konventave kryesore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të migrantëve.

## 1.1. Konventat e OKB-së

Disa nga konventat e OKB-së të paraqitura më poshtë adresojnë drejtpërdrejtë të drejtat e punëtorëve migrantë dhe disa të tjera të lidhura me këto të drejta. Konventat e mëposhtme, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, do të shqyrtohen në këtë analizë:

- Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, 1990, 1998.
- Protokollin shtesë kundër Trafikimit të Migrantëve nëpërmjet Tokës, Detit dhe linjave ajrore, 2000.
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore, 1966.
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966.
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial, 1969.
- Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1981.
- Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, 1990.
- Konventa për Parandalimin dhe Dënimin e Krimit të Genocidit të Miratuar nga Rezoluta 260 (III) e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara më 9 dhjetor 1948.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e Refugjatëve, 1951.
- Konventa mbi statusin e personave pa shtetësi, 1954, dhe konventa e reduktimit të pa shtetësisë, 1961.
- Konventa kundër torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe degraduese, 1987.
- Konventa mbi krimin e organizuar ndërkombëtar dhe protokollet e saj, 2000.

**Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre, 1990, 1998** (ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2007).

Të drejtat themelore për punëtorët migrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre të parashikuara nga Konventa janë: e drejta për lirinë e lëvizjes për dhe nga vendet e tyre të origjinës; e drejta për jetën; e drejta për liri nga tortura apo trajtimi ose dënimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues; e drejta e lirisë nga skllavëria, robëria ose puna e detyruar; e drejta e lirisë së mendimit, shprehjes, ndërgjegjes dhe

<sup>2</sup> Ikonimi, L. E drejta migratore. Material trajnues. (Migraton law. Training manual) IOM Tirana, 2009.

besimit; e drejta e privatësisë; e drejta e pronës;<sup>3</sup> e drejta e trajtimit të barabartë me vendasit në lidhje me shpërblimin dhe kushtet e tjera të punës, si puna jashtë orarit, pushimet, etj; e drejta për t'iu bashkuar lirisht çdo sindikate; e drejta për të gëzuar të njëjtin trajtim si vendasit në lidhje me përfitimet e sigurimeve shoqërore, nëse plotësohen kërkesat e legjislacionit; e drejta për kujdes shëndetësor emergjent;<sup>4</sup> e drejta e fëmijëve për të pasur emër, regjistrimin e lindjes dhe kombësisë; e drejta e regjistrimit në arsim;<sup>5</sup> e drejta për të ruajtur identitetin kulturor; e drejta për të transferuar të ardhurat dhe kursimet pas përfundimit të qëndrimit të tyre në shtetin e punësimit;<sup>6</sup> e drejta e informimit nga ana e shtetit të origjinës, shtetit të punësimit, apo shtetit transit për të drejtat e tyre si pasojë e kësaj Konvente, kushtet e pranimit të tyre, dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre në ato shtete;<sup>7</sup> e drejta për të formuar shoqata dhe sindikata në shtetin e punësimit; e drejta e barazisë së trajtimit me vendasit në lidhje me mbrojtjen kundër shkarkimit, përfitimet e papunësisë dhe qasje në punësim alternativ; në rast të shkeljes së kontratave të punës nga ana e punëdhënësit, e drejta për të trajtuar rastin e tij/saj tek autoritetet perkatese të shtetit të punësimit;<sup>8</sup> e drejta për të përfituar nga taksat e eksportit dhe importit; e drejta e barazisë së trajtimit me vendasit e shtetit të punësimit, duke përfshirë qasjen në shërbimet arsimore, profesionale dhe sociale.<sup>9</sup>

**Protokolli shtesë kundër Trafikimit të Migrantëve nëpërmjet Tokës, Detit dhe Linjave Ajrore, 2000** (ratifikuar nga Shqipëria në 2002).

Protokolli përcakton detyrimet për të mbrojtur trafikimin e migrantëve nëpërmjet Tokës, Detit dhe Linjave ajrore.

**Konventa Ndërkombëtar për të Drejtat Sociale, Ekonomike dhe Kulturore, 1966** (ratifikuar nga Shqipëria në 1991).

Konventa Ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore ndalon diskriminimin në ushtrimin e të drejtave të mbrojtura nga Konventa.<sup>10</sup>

**Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, 1966** (ratifikuar nga Shqipëria në 1991).

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike mbron të drejtat e mëposhtme: Të gjithë individët brenda territorit dhe subjekt i juridiksionit të një shteti gëzojnë të drejta civile dhe politike, pa dallim të çfarëdo lloji si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindjet politike apo opinione të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose ndonjë statusi tjetër;<sup>11</sup> Masat në kohë emergjencash publike nuk duhet të përfshijnë vetëm diskriminimin në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë apo origjinës sociale;<sup>12</sup> Të gjithë që janë në mënyrë të ligjshme në territorin e një shteti, kanë të drejtën e lirisë së lëvizjes dhe lirinë të zgjedhin vendbanimin e tyre, si edhe të jenë të lirë të largohen nga çdo vend, duke përfshirë vendin e tyre;<sup>13</sup> Çdo fëmijë ka të drejtë për mbrojtje pa asnjë diskriminim ndaj racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë ose lindjes;<sup>14</sup> Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë për mbrojtje të barabartë nga ligji kundër diskriminimit të bazuar në shkaqe si raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindjet politike ose bindje të tjera, kombëtare apo origjinës sociale, pasurisë, lindjes ose çdo statusi tjetër;<sup>15</sup> Personave që u

3 Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, Nenet 8-13.

4 Po aty, Nenet 25-28.

5 Po aty, Nenet 29-30

6 Po aty, Nenet 31-32.

7 Po aty, Neni 33.

8 Po aty, Neni 43.

9 Po aty, Neni 43.

10 Konventa ndërkombëtare për të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore, Neni 2.

11 Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike, Neni 2.

12 Po aty, Neni 4.

13 Po aty, Neni 12.

14 Po aty, Neni 24.

15 Po aty, Neni 2.

përkasin pakicave etnike, fetare ose gjuhësore nuk mund t'u mohohet e drejta për të gëzuar kulturën e tyre, për të praktikuar fenë e tyre, ose të drejtën që të përdorin gjuhën e tyre.<sup>16</sup>

**Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, 1981** (ratifikuar nga Shqipëria në 1994).

Konventa vendos masa politike, ligjore, sociale, ekonomike dhe kulturore për të siguruar përparimin dhe zhvillimin e plotë të grave, me qëllim që t'u garantohet atyre ushtrimi dhe gëzimi i të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore mbi bazën e barazisë me burrat.<sup>17</sup> Konventa u jep grave të drejta të barabarta me burrat për të fituar, ndryshuar ose mbajtur shtetësinë dhe të drejta të barabarta me burrat në lidhje me shtetësinë e fëmijëve të tyre.<sup>18</sup>

**Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve, 1990** (ratifikuar nga Shqipëria në 1992).

Konventa mbi të drejtat e fëmijëve përmban një sërë të drejtash si: e drejta për trajtim të barabartë pavarësisht racës, fesë, aftësive, llojit të familjes, vendit ku jeton, gjuhës, gjinisë, dhe kulturës;<sup>19</sup> e drejta për bashkim familjar: anëtarët e familjeve që jetojnë në vende të ndryshme duhet të lejohen të lëvizin ndërmjet këtyre vendeve në mënyrë që prindërit dhe fëmijët të kenë mundësinë të jenë në kontakt me familjarët, ose të bashkohen familjarisht;<sup>20</sup> mbrojtja e fëmijëve nga rrëmbimi, shitja, prostitucioni dhe pornografia;<sup>21</sup> e drejta për kujdes të veçantë, nga njerëz që respektojnë grupin e tyre etnik, fetar, kulturor dhe gjuhësor;<sup>22</sup> e drejta për kujdes dhe mbrojtje nëse fëmijët janë të adoptuar ose në kujdestari në vendin ku kanë lindur, ose nëse ata janë marrë për të jetuar në një vend tjetër;<sup>23</sup> e drejta për mbrojtje të veçantë dhe ndihmë për fëmijët që kanë qenë të detyruar të lënë shtëpitë e tyre dhe të jetojnë në një vend tjetër;<sup>24</sup> e drejta e fëmijëve vendas dhe pakicave të mësojnë dhe praktikojnë kulturën e tyre, gjuhën dhe fenë, në kushte ku praktikat nuk ndahen nga shumica e njerëzve në vend;<sup>25</sup> mbrojtja e fëmijëve nga rrëmbimet, shitjet apo trafikimi.<sup>26</sup>

**Konventa e Kombeve të Bashkuara në lidhje me Statusin e Refugjatëve, 1951** (ratifikuar nga Shqipëria në 1992).

Konventa miraton një përkufizim të vetëm të termit "refugjat": refugjat është një person, i cili nuk është në gjendje apo i gatshëm të kthehet në vendin e tij të origjinës për shkak të frikës së bazuar në persekutim për arsye të racës, fesë, kombësisë, anëtarësisë në një grup të veçantë social apo bindjeve politike.<sup>27</sup> Mbështetet nga një numër parimesh themelore, më së shumti mosdiskriminimit, mospenalizimit dhe moskthimit.<sup>28</sup> Konventa përcakton standardet minimale bazë dhe të drejtat për trajtimin e refugjatëve: aksesin në gjykata, në arsimin fillor, për të punuar, dhe sigurimi me dokumentacion, duke përfshirë edhe një dokument udhëtimi në formën e pasaportave.<sup>29</sup>

**Konventa mbi Statusin e Personave pa Shtetësi, 1954, dhe Konventa e Reduktimit të Pashtetësisë, 1961.**

Të dyja konventat nxisin uljen e numrit të personave pa shtetësi me anë të lehtësimit të procesit të marrjes së shtetësisë së personave pa shtetësi në vendin pritës.

**Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit, 1969** (ratifikuar nga Shqipëria në 1994).

16 Po aty, Neni 27.

17 Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, Neni 3.

18 Po aty, Neni 9.

19 Po aty, Neni 2.

20 Po aty, Neni 10.

21 Po aty, Neni 34.

22 Po aty, Neni 9.

23 Po aty, Neni 20.

24 Po aty, Neni 22.

25 Po aty, Neni 30.

26 Po aty, Neni 35.

27 Konventa e kombeve të bashkuara në lidhje me statusin e refugjatëve, Neni 1.

28 Po aty, Nenet 3, 33.

29 Po aty, Nenet 21, 22, 24, 26, 28.

Konventa synon mbrojtjen nga “diskriminim racor”;<sup>30</sup> i cili përkufizohet si çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes, apo origjinës kombëtare ose etnike, e cila ka për qëllim të ndikojë në zhvleftësimin ose dëmtimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, në mënyrë të barabartë, të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore apo ndonjë tjetër të jetës publike; kërkon që kombësia dhe shtetësia ose politikat e natyralizimit të mos diskriminojnë asnjë kombësi të caktuar; kërkon përparim të mjaftueshëm të grupeve të caktuara racore ose etnike apo individëve kundër diskriminimit racial; ndalon dhe synon eliminimin e diskriminimit racial në të gjitha format e tij dhe garantimin e të drejtave të mëposhtme: të drejtën e trajtimit të barabartë para gjykatave dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë; e drejta për sigurinë e personit dhe mbrojtjen nga shteti kundër dhunës ose lëndimit trupor, shkaktuar kjo qoftë nga zyrtarët e qeverisë apo nga ndonjë grup ose institucion tjetër; të drejtat politike, në veçanti të drejtën për të votuar dhe për t’u zgjedhur, në bazë të votimit të përgjithshëm dhe të barabartë, për të marrë pjesë në qeveri, në kryerjen e punëve publike dhe aksesit në shërbimet publike; të drejta të tjera civile, në veçanti të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banimit brenda kufijve të shtetit; të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, në veçanti: të drejtat për të punuar, për të zgjedhur lirisht profesionin, e drejta që të ketë kushte të favorshme pune, për mbrojtjen nga papunësia, për pagesë të barabartë për punë të barabartë, dhe të drejtën e shpërblimit të favoreshëm; e drejta për të formuar dhe për t’iu bashkuar sindikatave; e drejta për strehim; e drejta e aksesit në shëndetin publik, kujdesin mjekësor, sigurimin shoqëror dhe shërbimet sociale; e drejta për arsim dhe trajnim; e drejta për pjesëmarrje të barabartë në aktivitete kulturore.<sup>31</sup>

**Konventa kundër torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese, 1987** (ratifikuar nga Shqipëria në 2003).

Konventa synon moskthimin dhe mosdiskriminimin e një personi në të gjitha rastet kur besohet se ai/ ajo mund të torturohet nëse kthehet në vendin e vet ose për shkak të origjinës së tij.<sup>32</sup>

**Konventa mbi Krimin e Organizuar Ndërkombëtar dhe protokollet e saj, 2000** (ratifikuar nga Shqipëria në 2002).

Konventa synon të forcojë policinë ndërkombëtare dhe bashkëpunimin gjyqësor kundër krimit të organizuar.

## 1.2. Konventat e ILO-s

Më poshtë është përgatitur një përmbledhje e konventave të ILO-s, të cilat merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me të drejtat e punëtorëve migrantë të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Këto konventa janë: Konventa mbi Migrimin për Motive Punësimi (e rishikuar), 1949 (Nr. 97) dhe Rekomandime për Migrimin për Punësim (e rishikuar), 1949 (Nr. 86); Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, 1950; Konventa e Migrantëve Punëtorë, 1975 (Nr. 143) dhe Rekomandime për punëtorët migrantë 1975 (Nr. 151); Konventa e Agjencive private të punësimit, 1997 (Nr. 181); Konventa e punëtorëve vendas, 2011 (Nr. 189).

**Konventa mbi Migrimin për Motive Punësimi (i rishikuar), Nr. 97, dhe Konventa e Rekomandimeve për Migrimin për Punësim, Nr. 86, 1949** (ratifikuar nga Shqipëria në 2005).

Konventa dhe Rekomandimi synojnë këto të drejta: të drejtën e informacionit për politikat kombëtare, për ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me emigrimin dhe imigrimin;<sup>33</sup> të drejtën e shërbimit të përshtatshëm dhe të lirë për të ndihmuar migrantët me informacion të saktë për punësim;<sup>34</sup> e drejta

30 Konventa ndërkombëtare për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit, Neni 1.

31 Po aty, Neni 5.

32 Konventa kundër torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese, Nenet 1, 2.

33 Po aty, Neni 1.

34 Po aty, Neni 2.

e mbrojtjes nga propaganda mashtruese në lidhje me migracionin dhe migracionin;<sup>35</sup> e drejta për të pasur vëmendjen e duhur mjekësore dhe kushte të mira higjienike në kohën e nisjes, gjatë udhëtimit dhe pas mbërritjes në territorin e destinacionit;<sup>36</sup> e drejta e trajtimit jo më pak të favorshëm sesa ai që u jepet shtetasve së atij vendi në lidhje me çështjet e mëposhtme: shpërblim, anëtarësim në sindikata dhe gëzimin e përfitimeve nga negociatat kolektive, strehimi, siguracioni shoqëror, taksat apo kontributet, procedurat ligjore;<sup>37</sup> e drejta e transferimit të të ardhurave dhe kursimeve që kanë mbledhur migrantët ngamigra punësimi, pra migrasipas dëshirës.

**Konventa e Punëtorëve Migrantë, Nr. 143, dhe Rekomandime për Punëtorët Migrantë, Nr.151, 1975** (ratifikuar nga Shqipëria në 2006).

Konventa 143 e Punëtorëve Migrantë synon të respektojë të drejtat themelore të njeriut të të gjithë punëtorëve migrantë<sup>38</sup> dhe të mbrojë punëtorët migrantë nga trafikimi,<sup>39</sup> nga puna informale,<sup>40</sup> nga papunësia.<sup>41</sup> Po ashtu, Konventa garanton sigurinë e punësimit,<sup>42</sup> të trajtimit të barabartë për punëtorët migrantë dhe familjet e tyre<sup>43</sup> në lidhje me punësimin dhe profesionin; siguracioninshoqëror; sindikatat; të drejtat kulturore dhe të lirive individuale dhe kolektive për personat të cilët janë punëtorë migrantë ose anëtarët e familjeve të tyre janë ligjërish brenda territorit të saj,<sup>44</sup> ribashkimi i familjeve (fëmijët në ngarkim, babai dhe nëna) të të gjithë punëtorëve migrantë që banojnë ligjërish në territorin e saj,<sup>45</sup> etj.

**Konventa për Agjencitë Private të Punësimit, Nr. 181, 1997** (ratifikuar nga Shqipëria në 1999).

Konventa e Agjencive Private të Punësimit, Nr. 181, 1997 promovon barazinë e mundësive dhe të njëjtin trajtim në qasjen ndaj punësimit dhe ndaj profesioneve<sup>46</sup> dhe siguron që agjencitë private të punësimit t'i trajtojnë punëtorët pa i diskriminuar në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, fesë, mendimit politik, prejardhjes kombëtare, origjinës shoqërore, apo ndonjë formë tjetër të diskriminimit mbuluar nga ligjet dhe praktika kombëtare, të tilla si mosha apo paaftësia.<sup>47</sup>

**Konventa e Punëtorëve në familje, 2011 (Nr. 189)** (Nuk është ratifikuar nga Shqipëria).

Konventa e Punëtorëve në familje, 2011 (Nr. 189) përcakton të drejta dhe parime bazë, të tilla si liria e organizimit dhe e drejta për negociata kolektive, eliminimi i diskriminimit në lidhje me punësimin dhe profesionin,<sup>48</sup> imponon moshën minimale për punëtorët në familje, mbron kundër formave të abuzimit, ngacmimit dhe dhunës<sup>49</sup> dhe siguron trajtim të barabartë ndërmjet punëtorëve të brendshëm dhe të gjithë punëtorëve në përgjithësi në lidhje me orarin normal të punës, kompensimin jashtë këtij orari, periudhat e pushimit dhe lejen e paguar vjetore.<sup>50</sup>

35 Po aty, Neni 3.

36 Po aty, Neni 5.

37 Po aty, Neni 6.

38 Po aty, Neni 1.

39 Po aty, Neni 5.

40 Po aty, Neni 6.

41 Po aty, Neni 8.

42 Po aty, Neni 8.

43 Po aty, Neni 9.

44 Po aty, Neni 10.

45 Po aty, Neni 13.

46 Konventa për agjencitë private të punësimit, No. 181, Neni 5.

47 Po aty, Neni 5.

48 Po aty, Neni 3.

49 Po aty, Neni 5.

50 Po aty, Neni 10.



### 1.3. Politikat dhe standardet e Këshillit të Europës

Politikat dhe standardet kryesore të Këshillit të Europës të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me të drejtat e punëtorëve migrantë janë të përfshira në këto dokumente, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë: Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 1950; Karta Sociale Europiane (e rishikuar), 1961, 1996; Konventa Evropiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë, 1977; Konventa Kornizë e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1995; Konventa për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal, 1997; Konventa e Këshillit të Europës mbi Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005.

**Konventa Evropiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë, 1977** (ratifikuar nga Shqipëria në 2007).

Konventa Evropiane për Statusin Ligjor të Punëtorëve Migrantë, 1977, garanton të drejtën e marrjes në punë, e hyrjes dhe vendosjes në vendin e punës në mënyrë të lirë, garanton të drejtën për t'i pajisur migrantët me një kontratë punësimi para nisjes, të drejtën për informim, përjashtim nga detyrimet e importit dhe taksave, e drejta për t'u pajisur me leje pune dhe me leje qëndrimi, e drejta për asistencë mjekësore dhe sociale, e drejta e aksesit në gjykata dhe tek organet administrative, si edhe e drejta për të pasur mbrojtje të plotë ligjore dhe gjyqësore, etj.

**Karta Sociale Europiane (e rishikuar), 1961, 1996** (ratifikuar nga Shqipëria në 2002).

Duke supozuar se punëtorët migrantë dhe familjet e tyre kanë të drejtë për mbrojtje dhe asistencë në territorin e çdo pale tjetër, Karta parashikon këto të drejta: shërbime adekuate dhe falas në marrjen e informacionit të saktë mbi ligjet dhe rregullat kombëtare, kundër propagandës së gabuar lidhur me emigrimin dhe imigrimin; shërbimet e duhura për shëndetin, vëmendje mjekësore dhe kushte të mira higjienike gjatë ardhjes dhe largimit nga vendi pritës; shërbimeve sociale, publike dhe private, në emigrim dhe imigrim; trajtim jo më pak të favorshëm sesa ai i shtetasve të tjerë në lidhje me: shpërblimin, punësimin, kushtet e punës; anëtarësimin në sindikata dhe gëzimin e përfitimeve nga negociatat kolektive; strehimin; taksat nga punësimi, tarifatat ose kontributet; ribashkimin e familjes; transferimi i fitimeve dhe kursimeve; mësimi i gjuhës kombëtare të shtetit pranues; mësimin e gjuhës amtare të punëtorëve migrantë për fëmijët e punëtorit migrant.<sup>51</sup> Duke ratifikuar Kartën në vitin 2002, Shqipëria ka ndërmarrë përgjegjësitë që rrjedhin nga neni 19, i cili përcakton të drejtën për mbrojtje dhe ndihmë për punëtorët migrantë dhe familjet e tyre.

**Konventa e Këshillit të Europës për Veprimet kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005** (ratifikuar nga Shqipëria në 2007).

Konventa e Këshillit të Europës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2005 sanksionon këto detyrime për shtetet: formëson ose forcon koordinimin kombëtar midis organeve të ndryshme përgjegjëse për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore; politikat dhe programet për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore efektive; promovon një qasje, e cila bazohet tek të drejtat e njeriut dhe përdor një qasje mbështetur tek integrimi gjinor dhe që është e ndjeshme ndaj fëmijëve në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e të gjitha politikave dhe programeve; mundëson që migrimi të zhvillohet në mënyrë të ligjshme, veçanërisht nëpërmjet shpërndarjes së informacionit të saktë nga zyrat përkatëse, mbi kushtet që mundësojnë hyrjen e ligjshme dhe qëndrimin në vend; ul çënueshmërinë e fëmijëve ndaj trafikimit, veçanërisht duke krijuar një mjedis mbrojtës për ta;<sup>52</sup> përfshin organizatat joqeveritare, organizata të tjera përkatëse dhe elemente të tjera të shoqërisë civile të angazhuar në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen ose ndihmesën ndaj viktimeve; forcon masat administrative, arsimore, legjislativë, sociale, kulturore për të dekurajuar kërkesën që nxit të gjitha format e shfrytëzimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve që çon në trafikim;<sup>53</sup> ndërmerr

51 Karta sociale europiane (e rishikuar), Nenet 1-10.

52 Konventa e këshillit të europës për veprimet kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2000, Neni 5.

53 Po aty, Neni 6.

forcimin e kontrolleve kufitare për parandalimin dhe zbulimin e trafikimit të qenieve njerëzore;<sup>54</sup> zbaton masat e barazisë gjinore për të promovuar barazinë gjinore në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e masave.<sup>55</sup> Konventa nxit Qeverinë e Shqipërisë që të marrë masa për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore, veçanërisht femrave dhe të miturve, me banim në Shqipëri.

**Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, 1950** (ratifikuar nga Shqipëria në 1996).

Konventa e Këshillit të Europës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore, 1950 sanksionon të drejtat e mëposhtme: mbrojtja nga puna e detyruar;<sup>56</sup> liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë qoftë vetë ose në bashkësi me të tjerët publikisht ose privatisht;<sup>57</sup> të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë duhet të sigurohen pa diskriminim të çfarëdo lloji si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinioni politik ose tjetër, origjina kombëtare apo sociale, të qenurit pjesë e një minoriteti kombëtar, pasuria, lindja ose ndonjë status tjetër.<sup>58</sup>

**Konventa Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1995** (ratifikuar nga Shqipëria në 1999).

Konventa kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, 1995, sanksionon të drejtat e pakicave kombëtare: e drejta e barazisë para ligjit dhe te mbrojtjes së barabartë nga ligji. Në këtë kuptim, ndalohet çdo diskriminim bazuar në përkatësinë në një pakicë kombëtare;<sup>59</sup> e drejta për të ruajtur dhe zhvilluar kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore;<sup>60</sup> e drejta për të manifestuar fenë tij ose të saj ose besimin dhe për të krijuar institucione fetare, organizata dhe shoqata;<sup>61</sup> e drejta e lirisë së shprehjes;<sup>62</sup> e drejta për të mësuar dhe për të përdorur lirisht dhe pa ndërhyrje gjuhën e pakicës;<sup>63</sup> e drejta për të nxitur njohjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe fesë së pakicave të tyre kombëtare dhe të shumicës;<sup>64</sup> e drejta për të ngritur dhe për të menaxhuar institucione private të arsimit dhe trajnimit.<sup>65</sup> Konventa nxit qeverinë e Shqipërisë që të marrë masa për të mbrojtur identitetin, fenë, gjuhën, traditat dhe trashëgiminë kulturore të punëtorëve migrantë në vend.

**Konventa për Pjesëmarrjen e të Huajve në Jetën Publike në Nivel Lokal** (ratifikuar nga Shqipëria në 2005).

Konventa përcakton këto të drejta: të drejtën e shprehjes, organizimit dhe konsultimit me komunitetet lokale;<sup>66</sup> krijimin e strukturave konsultuese për të huajt në nivel lokal;<sup>67</sup> e drejta për të votuar në zgjedhjet administrative;<sup>68</sup> e drejta për informacion.<sup>69</sup> Konventa kërkon që qeveria e Shqipërisë të konsultohet me punëtorët migrantë për zhvillimet lokale dhe për politikatat që ndikojnë në punën dhe jetën e tyre në Shqipëri.

54 Po aty, Neni 7.

55 Po aty, Neni 5.

Ndërkohë, pjesëmarrja në tregun e punës e grave migrante nuk është problem, pasi ato përfaqësojnë një përqindje të vogël të punëtorëve migrantë në vend: 13.8 përqind në vitin 2012, 11.5 përqind në vitin 2013 dhe 8 përqind në vitin 2014. Kjo përqindje është e parëndësishme në krahasim me rritjen e numrit të grave migrante në Evropë, ku ato përbëjnë më shumë se 50 përqind të të gjithë migrantëve të pranuar.<sup>89</sup>

Rrjedhimisht, modeli i gruas migrante apo gruas që migron vetëm si shtylla e familjes janë ende në nivel embrional në Shqipëri.

Pjesa më e madhe e grave migrante në Shqipëri janë instaluar dhe integruar në tregun e punës, ndërkohë që një pjesë jetojnë në vend edhe si rezultat i bashkimit familjar. Zakonisht migrantët sjellin familjet e tyre në Shqipëri, dukuri e cila ka prodhuar një nivel të dukshëm të migracionit familjar në vend.

Tendencat e migrimit në Evropë janë duke u ndikuar nga migrimi për shkak të martesës, duke përfshirë edhe martesat me shkuesi dhe numrin në rritje të martesave nëpërmjet internetit. Këto tendenca nuk janë problem në Shqipëri.

Në Shqipëri, nuk ka pengesa për fuqizimin e grave migrante për shkak të statusit ligjor që ato mbajnë, kur vijnë në vend, si pothuajse të gjitha gratë punëtore që hyjnë ligjërisht në vend.

Në kontekstin evropian, gratë migrante përballen me diskriminim të dyfishtë të bazuar në gjininë e tyre, por edhe në origjinën e tyre etnike. Një prirje e tillë nuk është vënë re në Shqipëri. Shqipëria është nga vendet e pakta, të cilat kanë miratuar Konventën e OKB-së të vitit 1990 për të Drejtat e Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre (hyrë në fuqi në vitin 2003). Shqipëria ka ratifikuar këtë Konventë nga pozita si shtet dërgues. Megjithatë, ky ratifikim është duke ndikuar pozitivisht në respektimin e të drejtave të grave migrante në Shqipëri.

## 3.2. Boshllëqet në Legjislacion

Boshllëqet e legjislacionit në adresimin e çështjeve të migracionit në Shqipëri janë si më poshtë:

Ka një hendek të dukshëm midis adresimit të migrimit ndërkombëtar të shqiptarëve, migrimit të brendshëm, si dhe migracionit të të huajve në Shqipëri. Qeveria e Shqipërisë ka më shumë fuqi në trajtimin e problemeve të të huajve në vend dhe më pak akses për t'iu përgjigjur nevojave të migrantëve shqiptarë në vendet e destinacionit. Korniza aktuale ligjore adreson plotësisht migracionin në Shqipëri, por ka nevojë për të adresuar më tej migrimin e punëtorëve të brendshëm dhe migrimin ndërkombëtar nga Shqipëria. Shqipëria e ka më të zhvilluar legjislacionin si vend pritës dhe jo si vend dërgues.

89 Profili i Zgjeruar i Migracionit për Shqipërinë, 2012-2014, Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë, 2015.

Një tjetër hendek është në adresimin e grupeve të ndryshme të të huajve që banojnë ose punojnë në Shqipëri: legjislacioni aktual për të huajt është përqendruar kryesisht tek azili, azil-kërkuesit dhe refugjatët dhe më pak tek të drejtat e punëtorëve migrantë. Legjislacioni dhe institucionet shqiptare janë më të ndjeshme ndaj azilkërkuesve dhe refugjatëve në vend, dhe më pak ndaj migrantëve punëtorë në vend.

Ekziston edhe një hendek midis legjislacionit kryesor dhe udhëzimeve përkatëse të zbatimit të tij. Udhëzimet duhet të zhvillohen më tej, sidomos në përshkrimin e kërkesave për respektimin e të drejtave të punëtorëve migrantë gjatë zbatimit të procedurave ligjore të qëndrimit, punësimit dhe integritimit social në Shqipëri.

Kjo rrjedh nga dy rrethana:

- i) Nuk ka fokus të veçantë në trajtimin e të drejtave të punëtorëve migrantë në vend sepse legjislacioni trajton në përgjithësi të huajt që banojnë në Shqipëri.
- ii) Nuk ka fokus të veçantë në trajtimin e të drejtave të grave migrante në vend, sepse legjislacioni migrator nuk ka ndonjë referencë të veçantë për çështjet gjinore.

Legjislacioni migrator i Shqipërisë nuk ka dispozita ligjore që trajtojnë drejtpërsëdrejti perspektivën gjinore të migrantëve dhe barazinë gjinore. Për pasojë, ka lindur nevoja për të zhvilluar këto dispozita. Megjithatë, këto çështje janë trajtuar në përgjithësi nga legjislacioni mbi marrëdhëniet ekonomike dhe të punës, i cili u përgjigjet kërkesave të Konventës mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 1994.

Aktualisht legjislacioni shqiptar përcakton se leja e qëndrimit për anëtarët e familjes lëshohet të paktën gjashtë muaj pasi lëshohet leja e qëndrimit për migrantët. Kjo krijon një shpenzim të panevojshëm në kohë dhe energji nga ana e migrantëve dhe familjeve të tyre

Ka një hendek ligjor në lidhje me të drejtën e anëtarëve të familjes për të ruajtur lejen e qëndrimit në rast të shkurorëzimit apo vdekjes së punëtorit migrant. Ligji për të Huajt i vitit 2013 përcakton se leja e qëndrimit revokohet në rastet e divorcit, nëse kjo ndodh brenda 5 viteve të fitimit të saj, në rastet e vdekjes së migrantëve, nëse kjo ndodh brenda 3 viteve të fitimit të saj, dhe në rastet kur e drejta ligjore për kujdestari për fëmijë është ndërprerë. Kjo dispozitë shkel dispozitat e Konventës së OKB-së mbi të drejtat e punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre.<sup>90</sup>

Ekziston edhe një boshllëk në lidhje me të drejtën e migrantëve të parregullt për t'u anëtarësuar në sindikata. Ligji për të huajt i vitit 2013 përcakton që vetëm të huajt që banojnë dhe punojnë ligjërisht në Shqipëri mund të kenë akses në integrimin ekonomik dhe social në shoqërinë shqiptare. Kjo dispozitë gjithashtu shkel dispozitat e Konventës së OKB-së mbi të drejtat e punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre.<sup>91</sup>

Mangësitë e legjislacionit janë të lidhura kryesisht me mbrojtjen e fëmijëve të huaj në vend. Legjislacioni përcakton se fëmijët e migrantëve të paligjshëm mund të dërgohen në qendrat e paraburgimit vetëm si një masë e fundit dhe për një periudhë të shkurtër kohe.

Legjislacioni nuk përcakton të drejtën e azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave të kenë akses në programet e integritimit, ndihmën e shërbimet shoqërore, dhe strehimin.

Për këtë arsye, legjislacioni për mirëqenien sociale duhet të ndryshohet për të siguruar që azilkërkuesit të kenë qasje në programet e integritimit dhe ndihmën e shërbimet shoqërore.

Legjislacioni për strehimin social duhet të zbatohet edhe tek refugjatët që dhe ata të marrin mbrojtjen shtesë në Shqipëri.

Legjislacioni për arsimin nuk përcakton të drejtën e azilkërkuesve dhe fëmijëve refugjatë të ketë akses në arsim.

90 Konventa e OKB-së mbi të drejtat e punëtorëve migrantë dhe anëtarëve të familjeve të tyre, Neni 50.

91 Po aty, Neni 26.

### 3.3. Boshllëqe institucionale

Gjatë 25 viteve të fundit Shqipëria ka qenë dhe mbetet vend dërgues migrantësh. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe vendi ka shërbyer edhe si vend pritës i të huajve, punëtorëve migrantë ose profesionistëve dhe më vonë edhe studentëve.

Duke iu përgjigjur fluksit të migrantëve, siç u përmend më parë, vendi ka zhvilluar një kornizë ligjore pothuajse të plotë në trajtimin e çështjeve të migracionit. Megjithatë, ekziston një hendek ndërmjet kuadrit ligjor dhe kuadrit institucional në adresimin e këtyre çështjeve. Institucionet dhe agjencitë shtetërore rallë adresojnë të drejtat e punëtorëve migrantë në Shqipëri.

Institucionet publike bashkëpunojnë me partnerët socialë, organizatat jofitimprurëse dhe organizatat ndërkombëtare për promovimin dhe zbatimin e programeve të integritit të të huajve në shoqëri.

Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi, 2014-2020, miratuar në vitin 2014 parashikon edhe politika e masa, të cilat kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në garantimin e mbrojtjes së punëtrëve të huaj nga diskriminimi.

Gjithashtu, kuadri ligjor dhe institucional mbi të drejtat e punëtorëve migrantë nuk është i mbështetur nga kapacitetet e burimeve njerëzore në adresimin e këtyre çështjeve.

Shqipëria nuk ka as trashëgiminë institucionale, as kujtesën institucionale në trajtimin e migracionit. Hera e fundit që vendi ishte vend pritës i punëtorëve të huaj dhe i profesionistëve, ka qenë pothuajse një shekull më parë, gjatë viteve 1920-1930.

Pavarësisht zgjerimit të sistemit universitar në vend, nuk ka aktualisht fokus të veçantë në përgatitjen e specialistëve dhe menaxherëve mbi çështjet e migracionit.

Policia dhe punonjësit e institucioneve të zbatimit të ligjit nuk janë në dijeni të plotë të kërkesave dhe standardeve të menaxhimit të flukseve të migracionit, të drejtat e punëtorëve migrantë dhe në veçanti grave migrante.

Çështjet e migracionit janë trajtuar kryesisht nga institucionet qeveritare qendrore. Pushteti lokal është thuajse i papërfshirë në trajtimin, garantimin, mbështetjen ose monitorimin e të drejtave të punëtorëve migrantë.

Sindikatat në vend nuk kanë treguar ndonjë interes të veçantë në mbrojtjen e punëtorëve migrantë. Një përfaqësues nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë pohon se shumica e punëtorëve migrantë nuk janë anëtarë të sindikatave.

Organizatat e punëdhënësve kanë treguar një ndjeshmëri të dobët në respektimin e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri. Një përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë thotë se kjo është e lidhur me organizimin e dobët të sindikatave dhe të anëtarësimit të pakët të punëtorëve migrantë në lëvizjen sindikaliste.

Hendeku institucional më kritik është fakti se në Shqipëri nuk ekzistojnë institucionet shtetërore për të mbledhur, analizuar, monitoruar, ose informuar mbi respektimin apo shkeljen e të drejtave të migrantëve.<sup>92</sup>

92 Gjatë vrojtimit konsulenti konstatoi se, me përjashtim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, institucionet e tjera rallë grumbullojnë, analizojnë dhe shpërndajnë informacion mbi punëtorët e huaj.

# IV. Korniza institucionale dhe kapacitetet për monitorimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe aksesit në të drejta të punëtorëve migrantë

## 4.1. Korniza institucionale

Kuadri institucional për zbatimin e politikave të migracionit të punës në Shqipëri është si më poshtë: Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë; Ministria e Punëve të Jashtme; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Shëndetësisë; Ministria e Arsimit dhe Sportit; Instituti i Statistikave dhe organizatat ndërkombëtare, të tilla si Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (ONM), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Komisioneri i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF).

### **Ministria e Punëve të Brendshme**

Gjatë viteve të fundit, Ministria e Punëve të Brendshme është duke u bërë institucioni kryesor qeveritar në menaxhimin e politikave të migracionit. Një rol i tillë kryhet nga Policia e Shtetit, veçanërisht Drejtoria e Përgjithshme për Kufirin dhe Migracionin, Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët, si dhe Drejtoria e Përgjithshme kundër të Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda.

Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit është organ qeveritar, i cili menaxhon procedurat e hyrjes të të huajve dhe të qëndrimit të tyre në Shqipëri. Ajo operon në të gjithë territorin e vendit nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme me qendër në Tiranë dhe shtatë Drejtorive Rajonale.

Drejtoritë e mësipërme të Ministrisë së Punëve të Brendshme janë përgjegjëse për menaxhimin e kufijve dhe kontrollin, hyrjen, qëndrimin, shkëmbimin e informacionit mbi migracionin e parregullt në Shqipëri, luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, adresimin e çështjeve të azilkërkuësve, refugjatëve dhe shtetësisë etj.

### **Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë**

Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë zhvillon dhe monitoron politikat e punësimit, tregut të punës dhe të arsimit dhe formimit profesional, emigrimit të punës, shëndetin dhe sigurinë në punë, pensionet, asistencën sociale dhe mbrojtjen sociale, dialogun me partnerët socialë, sindikatat dhe organizatat e punëdhënësve, çështjet gjinore dhe mundësitë e barabarta, mbrojtjen e fëmijëve, të moshuarit, politikat anti-diskriminuese ndaj orientimit seksual, politikat për pakicat, marrëdhëniet etnike dhe fetare, politikat dhe shërbimet e aftësisë së kufizuar dhe politikat rinore.

### **Ministria e Punëve të Jashtme**

Ministria e Punëve të Jashtme, përmes njërive të saj si Drejtoria për Çështjet Konsullore dhe Drejtoria e Diplomacisë Publike, Partneritetet dhe Diasporës, është përgjegjëse për politikat e vizave, bashkëpunimin ndërkombëtar për migracionin dhe mbështetjen e migrantëve dhe diasporës jashtë vendit Shqipërisë, politikat mbi të huajt në Shqipëri.

**Ministria e Drejtësisë**

Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për të garantuar qasje të plotë të të huajve në organet dhe sistemin e drejtësisë. Kjo qasje lehtësohet nga Dhoma e Avokatëve dhe Zyra e Ndihmës Ligjore. Këto shërbime garantojnë respektimin e procedurave ligjore për të huajt në gjykata. Ministria e Drejtësisë është pika e kontaktit për ankesat e të huajve për trajtimin e tyre në sistemin e drejtësisë. Të huajt paraqesin ankesat e tyre edhe nëpërmjet ambasadave të tyre respektive në Tiranë, të cilat i përcjellin këto ankesa në Ministrinë e Drejtësisë.

**Ministria e Shëndetësisë**

Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e promovimit të shëndetit, politikave parandaluese, politikave dhe shërbimeve diagnostike dhe të trajtimit shëndetësor, duke garantuar akses në shërbimet mjekësore e shëndetësore për të gjithë qytetarët, (përfshirë migrantët), bazuar në skemat në dispozicion për popullsinë vendase. Organi kryesor që merret me shërbimet e ofruara për migrantët është Drejtoria e Shëndetit Publik.

**Ministria e Arsimit dhe Sportit**

Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e kushteve për shkollimin dhe integrimin arsimor të të huajve në Shqipëri, si dhe për mbështetjen e arsimit dhe shkollimit në gjuhën shqipe të migrantëve shqiptarë në vendet pritëse.

**Instituti i Statistikave, INSTAT**

INSTAT është përgjegjës për mbledhjen, përpunimin, analizën, shpërndarjen dhe publikimin e statistikave mbi emigrimin e shqiptarëve. INSTAT kryen anketime periodike dhe prodhon raporte të emigrimit të shqiptarëve, por jo mbi migracionin në Shqipëri.

**Organizatat ndërkombëtare**

Ka disa organizata ndërkombëtare që operojnë në Shqipëri që kanë misione me fokus të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi punëtorët migrantë: Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO), Komisioneri i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF).

Programet e zbatuara nga organizatat e mësipërme kanë një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në menaxhimin e migracionit dhe të drejtat e punëtorëve migrantë në Shqipëri. Këto programe kanë dhënë një kontribut të veçantë në zhvillimin e legjislacionit, duke mbështetur zhvillimin e teknologjive të informacionit, kryerjen dhe botimin e studimeve, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe zhvillimin e burimeve njerëzore që trajtojnë çështjet e imigrimit.

## 4.2. Mekanizmat monitorues

### 4.2.1. Mekanizmat monitorues ndërkombëtarë

Aktualisht Shqipëria ka nevojë për një monitorim më të mirë të zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë. Monitorimi më i mirë duhet të kryhet nëpërmjet mekanizmave më të përshatshme dhe funksionale.<sup>93</sup>

Instrumenti më i rëndësishëm i monitorimit mbi zbatimin e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri janë raportet periodike të paraqitura për ICRMW, Konventën e OKB-së mbi të Drejtat e Punëtorëve Migrantë dhe Anëtarëve të Familjeve të Tyre. Qeveria shqiptare raporton periodikisht për ICRMW për statusin e të drejtave të punëtorëve migrantë në vend. Megjithatë, duke iu referuar

93 Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, 13 shkurt 2014.

raporteve të vitit 2008<sup>94</sup> dhe 2010,<sup>95</sup> këto dokumente përmbajnë informacion të përgjithshëm mbi të drejtat e parashikuara nga legjislacioni i vendit dhe jo mbi zbatimin e të drejtave.

Mekanizma të tjerë të monitorimit janë: raportet periodike dorëzuar Komitetit për eliminimin e diskriminimit racor (CERD), Komitetit të të drejtave të njeriut, Komitetit për eliminimin e diskriminimit ndaj grave (CEDAW), dhe Konventës kundër torturës (CAT).

Raporti i fundit i Shqipërisë për CERD-në u paraqit në vitin 2012. Ai ka theksuar mungesën e të dhënave të detajuara, dallimin midis pakicave kombëtare dhe minoriteteve gjuhësore dhe mungesën e dokumenteve personale për romët në vend.<sup>96</sup>

Raporti i fundit i Shqipërisë për Komitetin e të Drejtave të Njeriut u paraqit në vitin 2014. Ai u përqendrua në hetimet për shkeljet e të drejtave të njeriut gjatë protestave të janarit 2011 dhe të trajtimit të azilkërkuesve në Shqipëri.<sup>97</sup>

Raporti i fundit i Shqipërisë për Komitetin CEDAW u paraqit në vitin 2012. Ai ka theksuar rastet e dhunës ndaj grave dhe rastet e aksesit të dobët të grave në kujdesin shëndetësor.<sup>98</sup>

Raporti i fundit i Shqipërisë për CAT u paraqit në vitin 2013. Ai u përqendrua në masat mbrojtëse ligjore për të burgosurit, hetime të rasteve të torturës, kompensimit të viktimave si dhe mbledhjen e të dhënave.<sup>99</sup>

Në vitin 2010, Shqipëria ka krijuar Zyrën e komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi, një organ i pavarur për promovimin e barazisë në vend.

Burimi kryesor ndërkombëtar mbi respektimin e të drejtave të migrantëve që hyjnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt janë raportet e Raportuesit Special të OKB-së dhe UNHCR-së. Raporti i fundit i Raportuesit Special u paraqit në vitin 2013. Raporti i fundit i Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) u paraqit në vitin 2013.<sup>100</sup>

### 4.2.2. Mekanizmat kombëtare të monitorimit

Disa nga instrumentet kombëtare për monitorimin e zbatimit të të drejtave të punëtorëve të huaj në Shqipëri janë: inspektimet e Inspektoratit Shtetëror të Punës; Regjistri Kombëtar Elektronik i të Huajve; grupi ndërministror i punës për Profilin Migracionit të Shqipërisë; hetimet e Avokatit të Popullit; raportet e institucioneve të zbatimit të ligjit; çështjet gjyqësore, raportet e OJQ-ve lokale, si Komiteti Shqiptar i Helsinkit.<sup>101</sup>

Shtypi dhe media botojnë raporte periodike mbi rastet e shkeljeve të të drejtave të migrantëve në Shqipëri. Shumica e këtyre raporteve përmbajnë informacion të dhënë nga burimet e përmendura më sipër.

Regjistri kombëtar elektronik i të huajve është krijuar në bazë të legjislacionit për të huajt, me një urdhër të përbashkët të Ministrit të Punëve të Jashtme, Ministrit të Punëve të Brendshme, Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Kryetarit të Shërbimit Informativ Shtetëror, Nr. 408/2, datë 01.03.2010. Regjistri është një bazë të dhënash elektronike, e cila mbledh dhe ruan të dhënat mbi veprimtarinë e institucioneve shtetërore që kanë të bëjnë me hyrjen, qëndrimin, punësimin, integrimin, tranzitimin dhe largimin nga Shqipëria. Regjistri është pjesë integrale e Sistemit Total të Menaxhimit të Informacionit (TIMS) të Policisë së Shtetit të Shqipërisë. Regjistri përbëhet nga modulet e mëposhtme: i) kontrolli

94 Raporti fillestar i Shqipërisë duhej të dorëzohej në 1 tetor 2008.

95 Raporti i 2010 ishte i fundit i dorëzuar nga Shqipëria. Raporti tjetër duhet të dorëzohej në nëntor 2015.

96 Po aty.

97 Po aty.

98 Po aty.

99 Po aty.

100 Po aty.

101 Informacionet nga këto burime përshkruhen në vijim.

kufitar; ii) E-viza; iii) E-Lejet e qëndrimit; iv) E-Lejet e punës;<sup>102</sup> dhe v) E-të huajt ilegalë. Regjistri është i furnizuar me të dhëna nga ana e institucioneve të mëposhtme: Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Shërbimi Informativ Shtetëror.

Me mbështetjen periodike të IOM-it, Qeveria e Shqipërisë harton dhe boton çdo vit Profilin e Migracionit të Shqipërisë, i cili përshkruan zhvillimet e fundit të emigracionit dhe të imigracionit në Shqipëri.

Instrumente të tjera të monitorimit për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri janë: raportet e Avokatit të Popullit, raportimet e shtypit dhe medias, komunikatat për shtyp të institucioneve të zbatimit të ligjit, raportet e OJQ-ve lokale, si Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Këto burime japin informacion sporadike për zbatimin ose shkeljen e të drejtave të punëtorëve të huaj në vend.<sup>103</sup> Aktualisht nuk botohen buletine të vendimeve gjyqësore ndaj punëtorëve migrantë.

### 4.3. Institucionet e monitorimit

#### **Avokati i Popullit**

Avokati i Popullit i Shqipërisë është organi kryesor publik, i cili monitoron zbatimin e të drejtave të njeriut dhe minoriteteve në Shqipëri.

Avokati i Popullit ka mandatin për të mbledhur ankesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe sistemin gjyqësor, prokurorinë dhe gjykatat.

Kërkesat dhe procedurat e ankesave shqyrtohen nga një hetim i pavarur administrativ, i cili përfshin marrjen e deklaratave nga persona të ndryshëm, aplikantë, personat të cilët kanë njohuri për ngjarjet, dhe shqyrtimin e këtyre të dhënave ose dokumente të shkruara që janë marrë nën administrim.

Zyra e Avokatit të Popullit është përqendruar kryesisht tek flukset e emigracionit që nisen nga Shqipëria drejt vendet pritëse të Bashkimit Evropian dhe të Amerikës së Veriut. Në vitin 2014, Avokati i Popullit zhvilloi një anketë mbi flukset në rritje të azilkërkuësve nga Shqipëria në Gjermani dhe vende të tjera të BE-së.<sup>104</sup>

Megjithatë, deri tani, Avokati i Popullit nuk ka treguar ndonjë interes të veçantë në monitorimin e të drejtave të punëtorëve migrantë.

#### **Komiteti Shqiptar i Helsinkit**

Drejtimit kryesor të veprimtarisë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit janë si më poshtë: i) Monitorimi me prioritet i të drejtave të njeriut dhe rekomandime për të drejtat e shkelura; ii) Lobim dhe advokaci për përmirësime në kuadrin ligjor dhe zbatimin e ligjit; iii) Rritja e vetëdijes dhe rritja e kapaciteteve të administratës shtetërore për të rritur përgjegjshmërinë e tyre për zbatimin korrekt të ligjeve; iv) Prioritizimi i aktiviteteve sipas fushave të të drejtave të njeriut dhe mundësive gjeografike; v) Respekti për të drejtën e votuesve shqiptarë për të votuar; vi) Respektimi i të drejtave të personave të ndaluar, arrestuar dhe të dënuar; vii) Respektimi i të drejtave të pakicave kombëtare dhe komuniteteve të tjera në vend; viii) Respektimi i të drejtave të shtetasve shqiptarë që vijnë në kontakt me organet gjyqësore shqiptare; ix) Respektimi i të drejtave të migrantëve shqiptarë.

Është e rëndësishme të theksohet se veprimtaria e Komitetit Shqiptar të Helsinkit nuk ka referenca të drejtpërdrejta në mbrojtjen e të drejtave të të huajve dhe të punëtorëve migrantë në Shqipëri.

<sup>102</sup> Moduli i E-Lejet e punës nuk është zbatuar akoma për arësye teknike.

<sup>103</sup> Disa nga gjetjet e këtyre instrumentave monitorues janë prezantuar në seksionet vijuese.

<sup>104</sup> "Faktorët që influencojnë rritjen e numrit të azil-kërkuësve nga Shqipëria në vendet e zonës Schengen", Avokati i Popullit, prill 2014.

**Organizata të tjera të shoqërisë civile**

Përveç Komitetit Shqiptar të Helsinkit, ka disa organizata të shoqërisë civile që veprojnë në Shqipëri, me fokus të veçantë mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve, të drejtat e të moshuarit, të drejtat e grave dhe të drejtat e grupeve të tjera të cënueshme të popullatës.

Megjithatë, deri tani, asnjë nga këto organizata nuk kanë kryer as sondazhe të veçanta, as procese monitorimi mbi zbatimin ose shkeljen e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri. Të dhëna për këto çështje nuk mblidhen rregullisht as nga burime zyrtare, si gjykatat apo prokuroritë.



# V. Sfidat e zbatimit/shkeljes së të drejtave të migrantëve në Shqipëri

## 5.1. Mungesa e mekanizmave efektivë dhe veprues për të monitoruar të drejtat e migrantëve në Shqipëri

Shqipëria nuk ka aktualisht as një mekanizëm operativ të mbledhjes së informacionit mbi zbatimin e të drejtave të migrantëve në vend, as një instrument për të monitoruar zbatimin apo shkeljet e të drejtave të migrantëve.

Të gjitha institucionet që supozohet të jenë përfshirë në zbatimin e të drejtave të migrantëve ose luftën kundër shkeljes së të drejtave të migrantëve dhe të përmendur në këtë raport (Inspektoratit Shtetëror i Punës, Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, prokuroria, gjykatat, sindikatat, Avokati i Popullit) nuk kanë mbledhur rregullisht informacion mbi zbatimin/shkeljen e të drejtave të migrantëve. Rrjedhimisht, asnjë nga këto institucione nuk ka qenë në gjendje të ofrojë informacion të detajuar mbi këto çështje.

Për shkak të mungesës së këtyre të dhënave, shumica e informacioneve të përfshira në këtë raport janë mbledhur personalisht nga konsulenti, duke përdorur kryesisht kanalet informale dhe lidhjet private. Duke pasur parasysh mungesën e informacionit të dhënë nga institucionet, konsulenti kryejti vrojtime dhe u përfshi drejtpërdrejt në mbledhjen e informacionit të ri, i cili pasqyron realitetin në terren.

Për rrjedhojë, ekziston një nevojë e ndjeshme për të krijuar mekanizma operative për monitorimin e pajtueshmërisë, zbatimin apo grumbullimin dhe ofrimin e provave për rastet e shkeljes së të drejtave të migrantëve në Shqipëri dhe për t'ia raportuar këtë informacion mekanizmave ndërkombëtarë të monitorimit.

## 5.2. Konsiderata të përgjithshme mbi gjendjen e të drejtave të migrantëve

Legjislacioni shqiptar favorizon hyrjen, qëndrimin, punësimin dhe studimin e të huajve në Shqipëri. Trajtimi i punëtorëve migrantë pasqyron kulturën tradicionale të shqiptarëve mbi respektin dhe nderimin ndaj të huajve. Disa nga mesazhet më të rëndësishme të Kanunit të Lek Dukagjinit dhe Kanunit të Labërisë, janë të lidhura me të huajin dhe mikun.

Të huajt që banojnë në Shqipëri përbëjnë jo më shumë se 0.3 përqind të popullsisë së përgjithshme të vendit.<sup>105</sup>


Në vitin 2015 ka pasur 6,877 aplikime për leje qëndrimi, dhe 3,563 prej tyre, ose 52 përqind, për leje pune.<sup>106</sup> Më 1 janar 2016 në Shqipëri ishin 4,471 punëtorë të huaj, kundrejt një numri total prej 8,804 të huajsh. Kjo do të thotë se rreth 54 përqind e të huajve janë vendosur në Shqipëri për qëllime punësimi.<sup>107</sup>

105 Profili i Zgjeruar i Migracionit për Shqipërinë, 2012-2014, Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë, 2015.

106 Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Policia e Shtetit.

107 Profili i Zgjeruar i Migracionit për Shqipërinë, 2012-2014, Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë, 2015.

Fig. 5.1. Banorët e huaj dhe punëtorët e huaj në Shqipëri, 2015-2016.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit, Policia e Shtetit, Tiranë, 2016.

Informacioni i mësipërm tregon se ka nevojë për më shumë vëmendje në çështjet që lidhen me punëtorët e huaj, në krahasim me banorët e huaj në Shqipëri.

Megjithatë, ka pasur raste të ankesave për shkeljen e të drejtave të punëtorëve migrantë. Shumica e ankesave lidhen me mohimin e hyrjes, dhënies së Lejes së qëndrimit, lejes së punës dhe dëbimin nga vendi. Sipas përfaqësuesve të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, ankesat kanë qenë kryesisht kundër autoriteteve rajonale kufitare dhe të migracionit apo zyrave rajonale dhe vendore të punësimit në disa rrethe të vendit, si në Gjirokastrë, Korçë, Sarandë, etj.

Pjesa më e madhe e informacionit të tërthortë të përmendur në këtë raport vjen nga Inspektorati Shtetëror i Punës, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë, Zyra e Gjendjes Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë, Gjykata e Tiranës, Gjykata Administrative e Apelit në Tiranë, si edhe sindikatat.

Informacioni i drejtpërdrejtë mbi shkeljen e të drejtave të punëtorëve migrantë vjen nga intervistat me grupe të fokusuara migrantësh.

### 5.3. Të drejtat në punë

Burimi kryesor i informacionit mbi shkeljen e të drejtave të punëtorëve migrantë në vendin e punës është Inspektorati Shtetëror i Punës (ISHP).

Një përfaqësues i ISHP-së pohoi se nga Regjistri i Ankesave i ISHP-së nuk rezultojnë të jenë regjistruar ankesa të bëra nga punëtorët e huaj ose të huaj të vetëpunësuar.

Zakonisht, ankesat janë bërë nga punëdhënësit apo sipërmarrësit e huaj. Në përgjithësi, ata ankohen kundër dënimeve apo gjobave të vendosura nga inspektorët e Inspektoratit Shtetëror të Punës. Ankuesit kanë pretenduar se në disa raste gjobat nuk janë të bazuara në fakte dhe në raste të tjera gjobat ishin të ekzagjeruara.<sup>108</sup>

Në vitin 2015 inspektorët e ISHP-së kontrolluan 1,666 punëtorë të huaj dhe gjetën se vetëm 15 prej tyre nuk ishin të pajisur me leje pune.

Tabela e mëposhtme përshkruan rezultatet e inspektimeve të inspektorëve të ISHP-së gjatë vitit 2015.

108 Informacion nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

Tabela 5.1. Inspektimet dhe gjodat e inspektorëve të ISHP-së gjatë vitit 2015

Nr	Aktiviteti	Punëtorët e huaj	Punëtorët pa leje pune	Nr. i gjobave	Shuma
1	Agrikulturë	5	0	0	0
2	Miniera	547	0	3	4,120,000
3	Aktivite produktive	161	1	4	450,000
4	Shërbime themelore	3	2	3	3,520,000
5	Tregti	97	6	0	0
6	Ndërtim	743	0	0	0
7	Transport	1	0	0	0
8	Shërbime financiare	38	0	0	0
9	Shërbime të tjera	71	6	0	0
Total		1,666	15	10	8,090,000

Burimi: Raporti Vjetor i ISHP, 2015.

Gjatë vitit 2015, inspektorët e ISHP-së vendosën 101 gjoba administrative, 10 gjoba për kompanitë në pronësi të shtetasve të huaj, 6 prej të cilave janë ankimuar në Komisionin e Apelimit dhe të gjitha gjodat janë konsideruar në përputhje me ligjin.

Ky informacion tregon se të drejtat e punës të punëtorëve të huaj janë shkelur kryesisht nga punëdhënësit e huaj dhe se agjensitë përkatëse shqiptare, të tilla si Inspektorati Shtetëror i Punës, shërbejnë si mbrojtës dhe garantues të të drejtave të punëtorëve të huaj.

Bazuar në komunikim personal me autoritetet e ndryshme, rezulton se sindikatat e Shqipërisë nuk kanë treguar ndonjë interes të veçantë në mbrojtjen e drejtpërdrejtë ose monitorimin e të drejtave të punëtorëve të huaj. Megjithatë, sipas një përfaqësuesi nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, ata kanë ushtruar ndikim të tërthortë në mbrojtjen e këtyre të drejtave në kuadër të presionit të tyre për të përmirësuar legjislacionin e punës që adreson të drejtat e punëtorëve. Një përfaqësues nga Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë pohon se ndryshimet e fundit në Kodin e Punës së Shqipërisë u bënë në dhjetor 2015 dhe do të bëhen efektive në korrik 2016.

Migrantët sugjerojnë përmirësimin e procedurave të dhënies së lejeve të punës dhe lejeve të qëndrimit për anëtarët e familjeve të tyre: leja e qëndrimit për anëtarët e familjes duhet të lëshohet në të njëjtën kohë me lejen e qëndrimit për migrantët/kreun e familjes. Aktualisht leja e qëndrimit për anëtarët e familjes lëshohet të paktën gjashtë muaj pasi lëshohet leja e qëndrimit për migrantët. Ky ndryshim do të shmangë një shpenzim të panevojshëm të kohës dhe energjive të migrantëve dhe familjeve të tyre.

Ligji për të huajt i vitit 2013 përcakton se vetëm të huajt që banojnë dhe punojnë ligjërisht në Shqipëri mund të jenë anëtarë të sindikatave.

## 5.4. Aksesit në shërbimet publike

Niveli i kënaqësisë për respektimin e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri reflekton ndikimin e zbatimit të legjislacionit kombëtar dhe politikën ndaj punëtorëve të huaj si dhe sjelljen e institucioneve shqiptare, punëdhënësve dhe sipërmarrësve. Një nivel i tillë pasqyron edhe kulturën dhe sjelljen e shqiptarëve ndaj të huajve. Burimi kryesor për të eksploruar vlerësimin e migrantëve në qasjen e tyre në shërbimet publike, janë perceptimet dhe vlerësimet e anëtarëve të grupit të fokusuar me mësuesit dhe punonjësit e tjerë të *Turgut Ozal College* në Tiranë.

Mendimi i tyre i përgjithshëm është se shqiptarët janë shumë bujarë ndaj të huajve. Ata pranuan se zyrat publike ofrojnë shërbime të shpejta dhe efektive për të huajt.

Perceptimi i tyre për Shqipërinë, veçanërisht respekti që ata marrin nga popullsia lokale, është shumë më i mirë sesa pritej. Disa prej migrantëve që jetojnë aktualisht në Shqipëri kanë pasur përvoja të

migrimit në vendet e tjera dhe ata e konsiderojnë të punuarit dhe të jetuarit në Shqipëri si përvojën e tyre më të mirë të migracionit. Ata mendojnë se shqiptarët janë njerëzit më ndihmës dhe më miqësorë. Gjithashtu, ata pohuan se migrantët janë të mirëintegruar në shoqërinë shqiptare. Më konkretisht, migrantët turq rezulton të jetë bashkësia migrante më e mirëintegruar në Shqipëri.<sup>109</sup>

Megjithatë, ata mendojnë se ka një hendek midis kënaqësisë nga sjellja e qytetarëve shqiptarë dhe kënaqësisë nga shërbimet, agjensitë dhe institucionet publike. Niveli i kënaqësisë nga të qenit të ndihmuar nga qytetarët shqiptarë është më i lartë se niveli i kënaqësisë nga shërbimet publike.

Përveç kësaj, migrantët tregojnë se shqiptarët, bashkëpunëtorët e tyre, fqinjët apo zyrtarët, duhet të jenë më miqësorë ndaj njëri-tjetrit. Miqësia dhe bujaria që tregojnë ndaj të huajve duhet të karakterizojnë edhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

Gjithashtu, migrantët përmendën raste të problemeve që ata përjetojnë me agjensitë ligjzbatuese, si për shembull me oficerët e policisë.<sup>110</sup>

Migrantët pohuan një trend të përmirësimit të shërbimeve në spitalet publike, veçanërisht në Tiranë dhe Shkodër. Përmirësimin më të dukshëm ata e shohin tek vendosja e Kartës së Shëndetit.

Në disa raste ata nuk janë të mirëinformuar mbi tarifatat e shërbimeve publike dhe nuk e dinë se sa duhet të paguajnë për shërbime të caktuara.

Antarët e grupit të fokusuar raportuan një sjellje korrekte të zyrtarëve të qeverisë vendore, sidomos në Zyrat e Gjendjes Civile.

Migrantët u ankuan për cilësinë e dobët dhe efikasitetin e ulët të shërbimeve të transportit publik në Tiranë.

Ata pranuan se nuk kanë ndonjë problem në marrjen e informacionit mbi shërbimet në dispozicion për të huajt në Shqipëri. Pavarësisht pengesave gjuhësore, ata kanë akses në informacione në lidhje me ndryshimet ligjore dhe ato të politikave, si edhe në shërbimet e ofruara. Megjithatë, ata sugjerojnë se televizionet shqiptare duhet të transmetojnë më shumë informacion dhe lajme në gjuhën angleze dhe në gjuhë të tjera të huaja.

Migrantët pranuan se reklamat në televizionet dhe gazetatat shqiptare duhet të jenë më të kujdesshme në transmetime që ndikojnë negativisht tek fëmijët migrantë që u përkasin kulturave të ndryshme. Shpesh një informacion i tillë përmban imazhe të rrezikshme për fëmijët, sidomos lidhur me pijen, kumarin, seksin, etj. Ata sugjerojnë se imazhet seksuale në reklama në media duhet të filtrohen me kujdes nga rregullatori i transmetimit. Këto pamje i detyrojnë migrantët të evitojnë ndjekjen e emisioneve televizive, duke u kufizuar vetëm me edicionet informative.

Migrantët janë kritikë ndaj faktit që legjislacioni shqiptar e lejon aktivitetet e kumarit brenda në qytete, madje në qendër. Ata e konsiderojnë kumarin helm të jetës publike dhe sugjerojnë që kazinotë të zhvendosen jashtë qyteteve. Efekti i tyre negativ në edukimin e fëmijëve dhe shëndetin social të familjes duhet të shmanget, thonë ata.

Migrantët janë të vetëdijshëm për faktin se disa shërbime publike në Shqipëri janë të korruptuara. Për shembull, ata janë të njohur me perceptimin e publikut se sistemi i drejtësisë është i korruptuar dhe se ka presion të madh publik për të ndryshuar dhe për ta përmirësuar atë. Megjithatë, ata rrëfejnë se nuk kanë pasur përvoja të drejtpërdrejta të këqija me sistemin, sidomos me gjykatat. Për ta, perceptimi për korrupsionin e shërbimeve publike duket të jetë një perceptim i marrë nga të tjerët. Pjesa më e madhe e informacionit që kanë migrantët mbi korrupsionin në shërbimet publike në vend vjen nga media, kontaktet e tyre me bashkëpunëtorët, miqtë, fqinjët dhe prindërit e miqve të fëmijëve të tyre.

Në përgjithësi, punëtorët e huaj në Shqipëri jetojnë kryesisht në kushte të rehatshme strehimi.

109 Intervistë me grupet e fokusuar, Turgut Ozal College, Tiranë.

110 Mësuesit e Turgut Ozal College në Tiranë përmendën një rast aksidenti rrugor në Bulqizë dhe gjëja e parë që bënë policët ishte të kërkonin fajtorin, jo të ndihmonin njerëzit.

Ndonjëherë, këto kushte janë më të mira se ato të popullatës lokale. Kjo shpjegohet me pagat dhe të ardhurat më të larta të punëtorëve të huaj në krahasim me punëtorët shqiptarë. Ata zakonisht marrin me qera, shtëpi apo apartamente dhe kanë marrëdhënie miqësore me pronarët përkatës, që kujdesen për kushtet dhe shërbimet në banesa. Pronarët vazhdojnë t'i konsiderojnë qiramarrësit e huaj si miq të veçantë dhe i trajtojnë ata me miqësinë dhe nderin tipik që shqiptarët u kanë dhënë tradicionalisht të huajve.

Fëmijët e migrantëve në Shqipëri zakonisht shkojnë në shkolla ndërkombëtare ose të huaja. Migrantët rrëfejnë se ata nuk preferojnë të ndjekin shkollat shqiptare për arsyet e mëposhtme:

- Ata mendojnë se arsimi shqiptar nuk ndihmon arsimimin e tyre të mëtejshëm apo integrimin e tyre në tregun e punës;
- Gjuha shqipe duket shumë e vështirë për t'u mësuar;
- Disa prej migrantëve, si migrantët turq dhe grekë, preferojnë të dërgojnë fëmijët e tyre për të studiuar në kolegjet përkatëse turke e greke në Shqipëri;
- Ata janë kritikë për përmbajtjen dhe informacionin e teksteve shkollore, të cilat nganjëherë përcjellin njohuri të gabuara dhe modele të keqja sjelljesh;
- Shkollat shqiptare nuk janë konkurruese;
- Tarifat e larta të shkollave private shqiptare nuk justifikojnë cilësinë e tyre të mësimdhënies.

Migrantët, punëdhënës dhe punëmarrës, rrëfejnë se agjensitë shtetërore sillen në mënyrë korrekte me ta. Por ata e bëjnë dallimin midis sjelljes së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe inspektorëve tatimorë. Të parët janë miqësore dhe të fokusuar në ndihmën ndaj migrantëve, ndërkohë që inspektorët tatimorë janë të prirur të vendosin gjoba dhe të japin dënime.

Migrantët rrëfejnë se ata janë përgjithësisht të kënaqur me kushtet e tyre të punës. Megjithatë, ata kërkojnë hapësira më të shumta publike për të luajtur fëmijët e tyre, sidomos gjatë sezonit të dimrit. Në Tiranë janë kufizuar hapësirat publike dhe mundësitë argëtuese për fëmijët, sidomos gjatë kohës së dimrit.

Migrantët bëjnë dallimin midis sjelljes së njerëzve në hapësira publike dhe kornizës ligjore dhe asaj politike për rregullimin e një sjelljeje të tillë. Ata mendojnë se problemi qëndron tek sjellja e individëve në hapësira publike, jo tek veprimtaria e institucioneve. Megjithatë, ata sinjalizojnë rrezikun se ndonjëherë njerëzit janë në gjendje të prishin sistemin, si edhe anasjelltas.

## 5.5. Trajtimi i migrantëve që hyjnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt

Burimet kryesore ndërkombëtare për zbatimin e të drejtave të migrantëve që hyjnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt janë raportet e Raportuesit Special të OKB-së dhe të UNHCR-së.

Në vitin 2013, Raportuesi Special mbi migrantët, përveç respektimit të të drejtave të migrantëve, theksoi nevojën për informacion të përshtatshëm mbi azil-kërkuesit dhe dokumentimin më të mirë të rasteve të personave që kërkojnë mbrojtje në Shqipëri.<sup>111</sup>

Raportuesi Special mbi migrantët rekomandoi që në Shqipëri fëmijët e migrantëve nuk duhet të jetë subjekt i ndalimit, ose kjo mund të ndodhë vetëm në raste tejet të jashtëzakonshme, si një masë e fundit dhe për një periudhë fare të shkurtër kohore.<sup>112</sup>

Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) ka kërkuar që Shqipëria të sigurojë përkthyes për njerëzit që kërkojnë mbrojtje në vend.<sup>113</sup>

111 Raporti nga Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, sipas paragrafit 15 (b) të aneksit të rezolutës së Këshillit për të drejtat e njeriut 5/1 dhe paragrafi 5 i aneksit të rezolutes së Këshillit 16/21, Shqipëri, 13 shkurt 2014.

112 Po aty.

113 Po aty.

Burimi kryesor i brendshëm i statistikave për shtetasit e huaj që përpiqen të hyjnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt është Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit. Sipas këtij burimi, rreth 18 përqind e tyre, 471 nga 2,618, janë refuzuar për të hyrë në Shqipëri për disa arsye, si mungesa e dokumentave për të vërtetuar identitetin, shkelja e mëparshme e rregullave të banimit në Shqipëri, mungesa e mbështetjes financiare, mosjustifikimi i arsyes së dhënë për të hyrë në vend, etj.<sup>114</sup>

Një tjetër burim kombëtar i informacionit për trajtimin e migrantëve që hyjnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt është Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Gjatë viteve të fundit Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka kryer tre misione hetimore në pikat kufitare Shqipëri-Greqi për të monitoruar trajtimin e të huajve që hyjnë në Shqipëri në mënyrë të parregullt.

Raporti i parë hartuar në vitin 2006 adreson nevojën për më shumë vëmendje dhe kujdes për emigrantët shqiptarë në pikat kufitare.<sup>115</sup>

- Raporti vlerësoi se infrastruktura në pikat kufitare është e dobët;
- Raporti sugjeroi nevojën për rritjen e kapaciteteve profesionale të policëve që shërbejnë në pikat kufitare;
- Raporti propozoi që policia kufitare duhet të jetë më e vetëdijshme në zbatimin e legjislacionit specifik për kontrollin dhe menaxhimin e kufijve.

Raporti i dytë, i hartuar në vitin 2012, merret me respektimin e të drejtave jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të të huajve në pikat kufitare.<sup>116</sup> Raporti konstaton se:

- Infrastruktura e qendrave pritëse në pikat e kontrollit kufitare mbetet e dobët;
- Nevojat themelore të imigrantëve të parregullt të mbajtur në qendër janë plotësuar në mënyrë të pamjaftueshme;
- Nuk kanë siguruar kushtet bazë për gratë;
- Shpesh nuk ka ushqim të mjaftueshëm;
- Shërbimi i informacionit është i varfër;
- Zakonisht gratë migrante të parregullta janë trajtuar nga police gra, të cilat përbëjnë rreth 50 përqind të stafit të policisë në Aeroportin Ndërkombëtar të Tiranës dhe 25 përqind të punonjësve të policisë në portin e Durrësit;
- Kapacitetet profesionale të policëve që u shërbejnë migrantëve të parregullt nuk janë rritur;
- Policia ka nevojë për më shumë trajnime specifike për legjislacionin për të drejtat e njeriut dhe për procedurat e mbrojtjes së migrantëve të huaj të parregullt nga keqtrajtimi;
- Ekziston një bashkëpunim i mirë mes policisë shqiptare dhe greke në trajtimin e migrantëve të parregullt të cilët kalojnë kufirin greko-shqiptar.

Raporti i tretë, i lëshuar në 2015, ka monitoruar procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj, të cilët kalojnë kufirin në mënyrë të parregullt me qëllimin përfundimtar hyrjen në vendet e BE-së, në tetë pikat e kontrollit të Shqipërisë së Jugut.

- Raporti përmend se shërbimet për migrantët e parregullt të intervistuar në qendrat ditore të pritjes janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e tyre për ushqim, strehim, shërbime shëndetësore dhe shërbime informacioni.
- Raporti konstaton gjithashtu se nuk ka oficere femra të policisë për të trajtuar femrat migrante të parregullta.<sup>117</sup>

114 Profili i Zgjeruar i Migracionit për Shqipërinë, 2012-2014, Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë, 2015;

115 Më shumë vëmendje për trajtimin e emigrantëve shqiptarë në pikat e kalimit kufitar, Përfundime të vëzhgimeve të Komitetit Shqiptar të Helsinkit në pikat e kalimit kufitar, prill 2006.

116 Raport mbi monitorimin e respektimit të të drejtave të shtetasve në pikat e kalimit kufitar, shkurt 2012.

117 Konkluzione mbi monitorimin e zhvilluar në pikat kufitare në Sarandë, Gjirokastër, Korçë dhe Pogradec, janar 2015.

## 5.6. Qasja në Sistemin e Drejtësisë

Të huajve në Shqipëri u është garantuar, ligjërisht dhe praktikisht, trajtim i barabartë në sistemin gjyqësor. Si legjislacioni, ashtu edhe procedurat pasqyrojnë kulturën tradicionale shqiptare, e cila e konsideron të huajin mik, i cili meriton respekt dhe nderim të veçantë.<sup>118</sup>

Gjykatat e Qarkut, Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk japin informacion për rastet në bazë të kombësisë/shtetësisë. Konsulenti analizoi informacionin e dhënë nga Gjykata e Rrethit Tiranë<sup>119</sup> dhe Gjykata e Lartë e Shqipërisë<sup>120</sup> dhe nuk ka gjetur ndonjë informacion në bazë të kombësisë/shtetësisë tek rastet e paraqitura nga migrantët apo rastet kundër migrantëve.

Përveç kësaj, është e vështirë për të identifikuar fushën e rasteve kundër ose nga punëtorët migrantë ngaqë institucionet përkatëse nuk filtrojnë informacionin në përputhje me statusin e banorëve të huaj në Shqipëri.

Megjithatë, nga burimet e mësipërme vihet re informacioni i pjesshëm në rastet e paraqitura kundër të huajve ose rasteve të paraqitura nga të huajt.

Rastet civile të paraqitura nga migrantët në Shqipëri janë bërë zakonisht për shkeljen e marrëdhënieve të punës:<sup>121</sup>

- Shkelje e marrëdhënieve kontraktuale nga kompanitë/punëdhënësit shqiptarë në dëm të punëtorëve të huaj;
- Shkelje e marrëdhënieve kontraktuale nga kompanitë/punëdhënësit e huaj në dëm të punëtorëve të huaj;
- Shkelje e procedurave të punësimit/largimit të punëtorëve të huaj nga kompanitë/punëdhënësit shqiptarë;
- Shkelje e procedurave të punësimit/largimit të punëtorëve të huaj nga kompanitë/punëdhënësit e huaj.

Raste të tjera penale janë ngritur për çështjet e mëposhtme (renditur sipas frekuencës)<sup>122</sup>:

- Vjedhjet;
- Përdorimi i dhunës;
- Denigrimi;
- Fyerje;
- Pastrimi i produkteve të krimit ose veprimtarisë kriminale;
- Përvetësimi i parave ose mallrave.

Rastet penale të ngritura kundër migrantëve në Shqipëri janë bërë zakonisht për çështjet në vijim:<sup>123</sup>

- Gabim mjekësor;
- Përdorim dhe bërja publike e informacionit të privilegjuar të paautorizuar;
- Manipulimet e çmimeve;
- Manipulimet e tregut;
- Keqpërdorimi i pushtetit dhe kompetencave;
- Prostitucioni;
- Shfrytëzimi i prostitucionit;

118 Intervistë me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë.

119 Raport Vjetor i Gjykatës së Rrethit Tiranë, 2014. [www.gjykatatirana.gov.al/previewdoc.php?file\\_id=208](http://www.gjykatatirana.gov.al/previewdoc.php?file_id=208) (marrë më 30 dhjetor 2015).

120 Raport Vjetor i Gjykatës së Lartë, 2012. [www.gjykataelarte.gov.al/web/Publikime\\_7\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Publikime_7_1.php) (30 dhjetor 2015).

121 Informacion nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë.

122 Informacion nga Gjykata e rrethit, Tiranë.

123 Informacion nga Prokuroria e Tiranës.

- Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike;
- Pastrimi i produkteve të krimit ose veprimtarisë kriminale;
- Dhënia makinës në gjendje të dehur apo pa patentë;
- Falsifikimi i vulave ose formave;
- Korrupsioni;
- Vetë-gjykimi;
- Falsifikimi i dokumenteve;
- Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor;
- Shtrëngimi ose pengimi për të bashkëjetuar ose përfundimin e martesës;
- Mashtrim i sigurimeve;
- Falsifikimi i akteve të gjendjes civile;
- Kontrabanda;
- Prodhimi dhe mbajtje pa leje e armëve të ftohta;
- Falsifikimi i kartave të identitetit, pasaportave ose vizave;
- Ndihma për kalim të parregullt të kufirit.

Disa nga dosjet kundër migrantëve janë apeluar në Gjykatën e Lartë dhe në Gjykatën e Apelit në Tiranë:

- Shkelje e procedurave të punësimit/pushimit të punëtorëve shqiptarë nga kompanitë/punëdhënësit të huaj;<sup>124</sup>
- Shkelje e marrëdhënieve kontraktuale nga kompanitë/punëdhënësit e huaj në dëm të punëtorëve shqiptarë;<sup>125</sup>
- Shkelje e rregullave të mbrojtjes në punë/sigurisë në punë.<sup>126</sup>

Burime nga Zyra e Prokurorit të Qarkut të Tiranës rrëfejnë se ka rreth 10 raste në muaj të paraqitura nga të huajt në Shqipëri, që paraqesin kallëzime penale për shkeljen e të drejtave të tyre ose dëmtimin e interesave të tyre.<sup>127</sup>

Ndërkohë, ka rreth 60 kallëzime penale në vit kundër të huajve në Shqipëri, të paraqitura në Zyrën e Prokurorit të rrethit të Tiranës: në 2015 ka pasur 57 kallëzime penale kundër të huajve. Akuzat penale kundër të huajve përbëjnë rreth 0.5 përqind të numrit të përgjithshëm të kallëzimeve penale në vend. Rastet e paraqitura nga të huajt në Zyrën e Prokurorit të rrethit të Tiranës përbëjnë rreth 1 përqind të numrit të përgjithshëm të rasteve të paraqitura në këtë zyrë.<sup>128</sup>

Ankesat e të huajve në Ministrinë e Drejtësisë për trajtimin e tyre në gjykatat kanë qenë kryesisht për dy arsye:

- Shkelje e të drejtës së tyre për të pasur përkthyes gjatë gjithë procesit;
- Kohëzgjatja e procedurave të rasteve të tyre.

Megjithatë, një përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë theksoi se gjatë vitit 2015 ka pasur vetëm një rast të ankesave që lidhen me mungesën e përkthyesit gjatë procesit në gjykatën e Tiranës.

Një kanal i ankesave të të huajve për sistemin gjyqësor në Shqipëri është edhe nëpërmjet ambasadave respektive në Tiranë, të cilat i ndjekin ankesat në Ministrinë e Drejtësisë. Megjithatë, zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë konfirmojnë se gjatë vitit 2015 nuk ka pasur ankesa serioze nga të huajt për shkeljen e ndonjë të drejte, gjatë rasteve të gjyqimit në gjykata.

124 Vendim i Gjykatës së Lartë, Nr. 331, datë 30.05.2013.

125 Vendim i Gjykatës së Lartë, Nr. 8, datë 10.06.2011.

126 Informacion nga Gjykata Administrative e Apelit, Tiranë.

127 Informacion ng Prokuroria e Tiranës.

128 Po aty.



## 5.7. Trajtimi në institucionet e vuajtjes së dënimit

Burimi kryesor i informacionit mbi trajtimin e punëtorëve migrantë në institucionet vuajtjes së dënimit është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në Ministrinë e Drejtësisë. Informacioni referohet në përgjithësi për të burgosurit e huaj dhe nuk ka informacion specifik mbi punëtorët migrantë të burgosur.

Autoritetet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve vlerësojnë se të burgosurit e huaj trajtohen në mënyrë të barabartë me shqiptarët. Nuk ka raste të shkeljes së të drejtave të tyre mbi baza etnike apo të shtetësisë.

Shumica e të burgosurve të huaj janë të dënuar për krime penale, të tilla si përfshirja në trafikun e narkotikëve.

Në nëntor 2015 në burgjet shqiptare kishte 93 të burgosur. Shumica e tyre, rreth 30 përqind, ishin nga Kosova/KSKB 1244 15 përqind nga Italia, 12 përqind nga Maqedonia, 9 përqind nga Greqia, dhe 5 përqind nga Rumania.<sup>129</sup>

Tabela 5.2. Të burgosurit në burgjet shqiptare në nëntor 2015

Nr.	Shteti	Numri
1	Kosova/KSKB 1244	33
2	Itali	14
3	Rumania	5
4	Spanja	1
5	Greqia	8
8	Mbretëria e Bashkuar	1
9	Maqedonia	11
10	Turqia	4
11	Siria	2
12	Kolumbia	2
13	Serbia	3
14	Norvegjia	1
15	Mali i Zi	2
16	Kroacia	1
17	Bosnje Hercegovina	1
18	Guinea	2
19	Kongo	1
	Totali	93

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhjetor 2015.

Siç tregon tabela 5.2, shumica e të burgosurve, 90 persona, janë meshkuj dhe vetëm 3 nga 93 janë gra.

Tabela 5.3. Gjinia e të burgosurve në burgjet shqiptare në nëntor 2015

Total	Meshkuj	Femra
93	90	3

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhjetor 2015.

Shumica e të burgosurve, 41 nga 93, janë vendosur në institucionet penitenciare në Tiranë, 15 në Fier, 17 në Lezhë dhe pjesa tjetër në institucionet e Fushë-Krujës, Korçës, Kukësit, Durrësit, Kavajës dhe Tepelenës.

<sup>129</sup> Raport Vjetor i vitit 2015, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Tabela 5.4. Shpërndarja e të burgosurve në burgjet shqiptare në nëntor 2015

Nr.	Qyteti/Institucioni	Numri i të burgosurve
1	Fier	15
2	Tirana/Vaqarr	1
3	Tirana/Ali Demi	3
4	Tirana/Mine Peza	19
5	Tirana/Jordan Misja	18
6	Fushë Krujë	7
7	Lezhë	17
8	Korçë	3
9	Kavajë	1
10	Tepelenë	1
11	Kukës	2
12	Durrës	5
	Total	93

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhjetor 2015.

Shumica e të huajve në burgjet shqiptare, 66 nga të 93, ishin në paraburgim ndërsa pjesa tjetër, 27 nga 93 vuajnë dënimin. Koha maksimale e dënimit është 20 vjet burgim; minimumi është 3 vjet e 4 muaj.

Tabela 5.5. Tipologjia e të burgosurve në burgjet shqiptare në nëntor 2015

Total	dënuar	kujdestari
93	27	66

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, dhjetor 2015.

## 5.8. E drejta e familjarëve për tu pajisur me lejeqëndrimi

Komiteti ICRMW në seancën e trembëdhjetë më 22 nëntor-3 dhjetor të vitit 2010, i bëri thirrje Qeverisë së Shqipërisë për të siguruar informacionin në raportin e ardhshëm periodik mbi zbatimin e të drejtave të punëtorëve migrantë. Raporti përfundon me një përmbledhje të konkluzioneve dhe të rekomandimeve që do të duhet të merren në konsideratë për të përmirësuar mbrojtjen e të drejtave të migrantëve. Më kryesoret janë:

- Respektimi i neneve 76 dhe 77 të Konventës në lidhje me detyrimin e qeverisë për të dërguar komunikime në Komitetin ICRMW;
- Parandalimi për punëtorët migrantë dhe anëtarët e familjeve të tyre i formave të ndryshme të diskriminimit në fushën e sigurimeve shoqërore;
- Zgjerimi i aksesit të punëtorëve migrantë në drejtësi përmes rritjes së ndërgjegjësimit në lidhje me mjetet administrative dhe gjyqësore në dispozicion të tyre;
- Sigurimi i rinovimit të lejes së qëndrimit për anëtarët e familjes në rast të shkurorëzimit ose në rast të vdekjes së punëtorit migrant;
- Sigurimi se punëtorët migrantë pa dokumenta dhe anëtarët e familjeve të tyre do të lejohen të anëtarësohen në sindikata.<sup>130</sup>

Megjithatë, rekomandimi i fundit nuk është marrë në konsideratë. Ligji për të huajt i vitit 2013 përcakton se leja e qëndrimit revokohet në rastet e divorcit, nëse kjo ndodh brenda 5 viteve pas lëshimit, në rastet e vdekjes së migrantëve, nëse kjo ndodh brenda 3 viteve pas lëshimit, dhe në rastet kur e drejta ligjore e kujdestarisë për fëmijë është ndërprerë.

<sup>130</sup> Konkluzione të Komitetit ICRMW 22 nëntor-3 dhjetor 2010;

# VI. Gjetjet dhe Rekomandimet

## 6.1. Gjetjet

Gjatë studimit të zbatimit të të drejtave për punëtorët migrantë dhe të drejtat e grave migrante në Shqipëri, konsulenti arriti në këto përfundime:

1. Shqipëria ka ratifikuar dhe po zbaton me sukses shumicën e konventave ndërkombëtare për punëtorët migrantë. Edhe pse një vend tipik dërgues migrantësh, Shqipëria ka një kuadër pothuajse të plotë ligjor për migrantët.
2. Kuadri i plotë ligjor mbështetet vetëm pjesërisht nga kuadri institucional për punëtorët migrantë. Veçanërisht, kapacitetet institucionale për trajtimin e të drejtave të migrantëve janë të kufizuara.
3. Burimet njerëzore që kanë të bëjnë me punëtorët migrantë dhe të drejtat e tyre nuk janë në koherencë me kuadrin ligjor dhe institucional që ka zhvilluar, krijuar dhe përmirësuar gjatë viteve të fundit Shqipëria.
4. Nuk ka dispozita ligjore që të trajtojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë perspektivën gjinore të migrantëve dhe barazinë gjinore.
5. Gjatë viteve të fundit, janë shtjelluar dhe hartuar politika të veçanta dhe disa dispozita ligjore për të nxitur punësimin dhe për të mbrojtur të drejtat e grave në tregun e punës në Shqipëri. Megjithatë, vendi nuk ka mundur të zhvillojë dhe të zbatojë dispozitat ligjore për të promovuar në mënyrë specifike punësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave migrante në tregun e punës.
6. Deri tani, nuk ka pasur ndonjë përpjekje për mbledhjen e të dhënave administrative apo kërkimore mbi zbatimin, respektimin apo shkeljen e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri. Kjo edhe për shkak të faktit se institucionet dhe agjencitë që trajtojnë çështje të migracionit, veçanërisht në lidhje me punëtorët migrantë, nuk kanë kapacitetet dhe praktikën e nevojshme për të mbledhur, për të analizuar dhe për të dhënë këtë lloj informacioni.
7. Statistikat e punëtorëve të huaj nuk janë mbledhur apo publikuar as nga burimet administrative dhe as nga anketat e tregut të punës. Punëtorët migrantë nuk janë të përfshirë në bilancet e punësimit, papunësisë dhe të forcës së punës.
8. Informacioni i siguruar nga burimet zyrtare në zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe të drejtave të grave migrante në Shqipëri është i varfër, i kufizuar dhe shumë i përgjithshëm. Asnjë prej institucioneve nuk informojnë periodikisht Drejtorinë e Përgjithshme të Kufirit dhe të Migracionit për problematikat dhe sfidat që hasin gjatë punës ose gjatë qëndrimit në vend punëtorët migrantë, siç kërkohet nga legjislativi mbi migracionin.
9. Mungesa e informacionit i bën autoritetet kufitare dhe të migracionit më pak të fuqishme në mbledhjen e të dhënave, në analizën e situatës dhe për të dhënë rekomandime për ndryshime ligjore dhe për politikën e duhura për trajtimin e punëtorëve migrantë dhe për të drejtat e grave migrante në Shqipëri.

10. Të dhënat për të huajt në Shqipëri janë më shumë rreth azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave që hyjnë në vend në mënyrë të parregullt dhe më pak rreth punëtorëve migrantë apo rreth të drejtave të tyre sociale, ekonomike, politike e kulturore.
11. Fuqia që ka Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë apo agjencitë e saj në formulimin e politikave të migracionit apo ato të trajtimit të punëtorëve migrantë dhe të grave migrante është reduktuar, ndërkohë që Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet dhe agjencitë e saj e kanë rritur praninë e tyre në këtë fushë gjatë vitet e fundit. Trajtimi i migrantëve dhe të huajve në Shqipëri rrezikon të marrë konotacionin e një çështjeje të sigurisë publike dhe të rendit publik dhe të shihet më pak si një çështje sociale, ekonomike, kulturore apo një çështje që ka lidhje me lëvizjen e punëtorëve.
12. Këto tendencave kanë ndikuar negativisht në procesin e informimit dhe trajtimin e të drejtave të migrantëve, veçanërisht të drejtave të grave migrante në vend.
13. Pjesa më e madhe e informacionit të besueshëm për zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe të drejtave të grave migrante në Shqipëri vjen nga burime të drejtpërdrejta: nga punëtorët migrantë dhe familjet e tyre.
14. Autoritetet e qeverisjes vendore nuk kanë treguar interes ose kanë shfaqur interes të pamjaftueshëm për çështjet e migrantëve dhe të drejtat e punëtorëve migrantë që jetojnë dhe punojnë në territoret e tyre përkatëse.
15. As organizatat e punëdhënësve dhe as sindikatat nuk kanë treguar interes të dukshëm apo të qëndrueshëm për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe të grave migrante në Shqipëri.
16. Interes më të madh ndaj të drejtave të punëtorëve migrantë dhe të grave migrante në Shqipëri kanë treguar organizatat e shoqërisë civile, OJQ-të, veçanërisht Komitetit Shqiptar i Helsinkit dhe Avokati i Popullit.
17. Zbatimi i të drejtave dhe detyrimeve të punëtorëve të huaj në vend udhëhiqet nga parimet e respektimit të të drejtave të njeriut, eliminimit të diskriminimit për shkak të racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, kulturës, gjendjes ekonomike, seksit dhe gjinisë, nga transparenca e procesit, integriteti dhe dinjiteti i punëtorëve të huaj, e drejta e punëtorëve të huaj që të apelojnë vendimet e marra kundër tyre, e drejta për bashkim familjar dhe të drejtat e plota të familjarëve të tyre.
18. Të drejtat e punëtorëve migrantë zbatohen ngushtësisht me garantimin e sigurisë dhe rendit publik, ruajtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga rreziqet e mundshme.
19. Legjislacioni për të huajt kërkon gjithashtu disa garanci financiare dhe ekonomike në mënyrë që të huajt që banojnë, punojnë, studiojnë apo kryejnë aktiviteteve të tjera ekonomike, sociale, humanitare, fetare, kulturore apo aktivitete të tjera të ligjshme në vend të mos jenë apo bëhen barrë për sistemin e mirëqenies.
20. Të drejtat dhe përgjegjësitë e punëtorëve të huaj zbatohen dhe lehtësohen ose nga marrëveshjet dypalëshe ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe qeverive të vendeve dërguese, ose me ratifikimin e konventave ndërkombëtare të migrimit dhe të punës, si edhe në bazë të standardeve të OKB-së, IOM-it, ILO-s dhe të BE-së për punën dhe migrimin.
21. Në respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe grave migrante në Shqipëri ndikojnë edhe boshllëqet ligjore në trajtimin e migrimit ndërkombëtar, migrimit të brendshëm dhe imigrimin e të huajve në Shqipëri.
22. Në respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe grave migrante në Shqipëri ndikojnë edhe mangësitë e politikave në trajtimin e migrantëve dhe grave migrante në vend.
23. Në respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe grave migrante në Shqipëri ndikojnë edhe

- kapacitetet e kufizuara të burimeve institucionale dhe njerëzore që merren me zbatimin e të drejtave të punëtorëve migrantë dhe të drejtat e grave migrante në Shqipëri.
24. Televizionet shqiptare transmetojnë informacion të kufizuar në anglisht apo në gjuhë të tjera të huaja, e për rrjedhojë ky informacion nuk është i mjaftueshëm për informimin e punëtorëve migrantë.
  25. Instrumentet e monitorimit dhe institucionet e monitorimit të zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë dhe të grave migrante në Shqipëri janë të kufizuara.
  26. Moduli i lejeve elektronike (E-leje), si një instrument i rëndësishëm i monitorimit, nuk është zbatuar ende për arsye teknike.
  27. Avokati i Popullit nuk ka bërë rekomandime të drejtpërdrejta për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve në Shqipëri, si dhe të drejtat e atyre migrantëve që kanë kërkuar ndihmë e mbështetje nga ky institucion.
  28. Komiteti Shqiptar i Helsinkit rrallëherë bën referenca të drejtpërdrejta në mbrojtje të të drejtave të migrantëve në Shqipëri, apo në mbrojtje të të drejtave të migrantëve që kanë kërkuar ndihmë e mbështetje nga ky institucion.
  29. Punësimi i të huajve në Shqipëri është i kushtëzuar nga kërkesa për politikën e pagave. Legjislacioni përcakton si kusht të veçantë për dhënien e lejes së qëndrimit për qëllime punësimi që paga e punëtorëve të huaj, e parashikuar në kontratën e punës, duhet të jetë të paktën 150 përqind e pagës së vendasve.
  30. Pranimi i studentëve të huaj në universitetet shqiptare kushtëzohet me njohjen e gjuhës shqipe. Legjislacioni përcakton si kërkesë të veçantë për dhënien e lejes së qëndrimit për studentët provën e njohurive të gjuhës shqipe.
  31. E drejta për punë e investuesve të huaj është e kushtëzuar me kërkesat financiare. Legjislacioni përcakton si kërkesë të veçantë për dhënien e lejes së qëndrimit për investitorët që: i) vlera e investimeve duhet të jetë të paktën 1 milion Euro; ii) ata duhet të punësojnë të paktën 10 punëtorë shqiptarë për të paktën 1 vit.
  32. Në vitin 2005 Shqipëria ratifikoi Konventën mbi pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në nivel lokal, 1997, e cila u garanton të huajve që banojnë në mënyrë të ligjshme në një vend të drejtën e votës në zgjedhjet vendore. Megjithatë, kjo e drejtë nuk është zbatuar ende në Shqipëri.
  33. Legjislacioni shqiptar përcakton që në pranimin e punëtorëve migrantë, Shqipëria të aplikojë sistemin e kuotave, të cilat duhet të përcaktohen në mënyrë të përvitshme. Por aplikimi i kuotave ende nuk ka filluar, për shkak se nuk ka një vendim qeverie në zbatim të ligjit.
  34. Gjyqtarët dhe prokurorët nuk janë trajnuar në mënyrë të mjaftueshme për të kuptuar natyrën komplekse të shkeljeve të ligjit nga qytetarët e huaj dhe punëtorët migrantë në Shqipëri.
  35. Oficerët e Policisë së Shtetit nuk janë trajnuar në mënyrë adekuate të mjaftueshme për të kuptuar kontekstin e veprimeve dhe shkeljet e ligjit nga qytetarët e huaj dhe punëtorët migrantë në Shqipëri. Ata kanë nevojë për aftësi më të mira komunikimi.
  36. Personeli i shërbimeve psiko-sociale nuk është trajnuar në mënyrë të mjaftueshme për t'u përballur siç duhet me sfidat e punëtorëve migrantë, liria e të cilëve është privuar.
  37. Mjekët, infermierët dhe personeli i spitaleve dhe qendrave shëndetësore nuk janë trajnuar në mënyrë të mjaftueshme për të qenë të aftë për të përmirësuar shërbimet shëndetësore për të huajt dhe migrantët.
  38. Punonjësit e burgjeve kanë kapacitete të pamjaftueshme për trajtimin e të burgosurve të huaj.

## 6.2. Rekomandimet

Me qëllim përmirësimin e zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë dhe të grave migrante në Shqipëri, Konsulenti propozon rekomandimet e mëposhtme:

1. Trajtimi i imigrantëve dhe të huajve në Shqipëri duhet të ndryshohet nga trajtimi i saj si një çështje e sigurisë publike dhe e rendit publik, në trajtimin si një çështje sociale, ekonomike, kulturore dhe e lëvizjes së punëtorëve.
2. Duke marrë parasysh numrin e vogël të migrantëve për qëllime punësimi në Shqipëri dhe faktin që qeveria ende nuk ka marrë një vendim për aplikimin e kuotave, rekomandohet që të shfuqizohet legjislacioni mbi sistemin e kuotave. Zakonisht, sistemi i kuotave aplikohet në vende që përballen me flukse të mëdha migrantësh, të cilët rrezikojnë vendet e punës së vendasve. Shqipëria, në fakt, ka flukse të vogla, jo më shumë se 0.5përqind të numrit të përgjithshëm të të punësuarve në vend janë punëtorë të huaj. Përveç kësaj, Shqipëria ka nevojë për aftësitë, ekspertizën dhe kulturën e punës që sjellin në vend migrantët e punës.
3. Statistikat e punëtorëve të huaj duhet të mblidhen dhe të publikohen nga burimet administrative dhe nga anketat tremujore të tregut të punës dhe duhet të analizohen e të publikohen çdo vit.
4. Punëtorët migrantë duhet të përfshihen në informacionet që mblidhen për bilancin e punësimit, papunësisë dhe fuqisë punëtore, i cili grumbullohet dhe publikohet nga INSTAT-i.
5. Mbledhja e të dhënave mbi zbatimin, respektimin apo shkeljen e të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri duhet të bëhet në mënyrë institucionale dhe jo vetëm për detyrimet që rrjedhin nga Komiteti ICRMW.
6. Tek mbledhja e të dhënave për të huajt në Shqipëri duhet të vihet më shumë theks tek punëtorët migrantë, veçanërisht në lidhje me zbatimin apo shkeljen e të drejtave të tyre sociale, ekonomike, politike dhe kulturore.
7. Politikat e migracionit të Shqipërisë duhet të trajtojnë më gjerësisht sfidat dhe barrierat sociale dhe kulturore të punëtorëve migrantë dhe grave migrante në Shqipëri. Kjo nevojë vjen nga fakti se një pjesë e konsiderueshme e punëtorëve migrantë dhe grave migrante vijnë nga shoqëri, kultura dhe gjuhë të tjera.
8. Perspektiva e grave migrante në hartimin e politikave në vend duhet të fuqizohet, për të lehtësuar dhe për të përmirësuar integrimin e tyre social.
9. Politikat për punësimin e të huajve në Shqipëri duhet t'i japin prioritet dhe të lehtësojnë trajtimin e punëtorëve migrantë në disa sektorë kyç të ekonomisë dhe të punësimit, sidomos në prodhim dhe në sektorin e shërbimeve.
10. Politikat e migracionit në Shqipëri duhet të kenë për synim tërheqjen e investuesve të huaj në vend.
11. Politika lehtësuese duhet të zbatohen edhe për të promovuar pranimin e studentëve të huaj në universitetet shqiptare.
12. Procesi aktual i monitorimit dhe raportimit të zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri sugjeron krijimin e një mekanizmi të veçantë, për t'iu përgjigjur kërkesave të ICRMW-së.
13. Përveç institucioneve qeveritare të cilat përgatisin raportimin ICRMW, sugjerohet që një institucion i veçantë të kryejë monitorimin e rregullt të të drejtave të migrantëve. Ky institucion mund të jetë Avokati i Popullit i Shqipërisë ose Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ose të dyja. Për ta bërë këtë, misioni i të dyja institucioneve duhet të rishikohet.
14. Nevoja e monitorimit dhe raportimit të zbatimit të të drejtave të punëtorëve migrantë në Shqipëri sugjeron krijimin e një institucioni të veçantë, përveç institucioneve qeveritare, të

cilat përgatisin raportimin për ICRMW. Ky institucion mund të jetë Avokati i Popullit, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, ose të dyja. Për ta bërë të mundur këtë, duhet të rishikohet misioni dhe përshkrimi i punës së këtyre institucioneve.

15. Avokati i Popullit, përveç të drejtave të pronësisë, të strehimit, të konsumit apo të mjedisit si dhe të drejtave të atyre që kërkojnë ndihmë dhe mbështetje nga ky institucion, duhet të angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve në Shqipëri.
16. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, përveç të drejtave të vendasve dhe migrantëve shqiptarë në vendet pritëse si dhe të drejtave të atyre që kërkojnë ndihmë e mbështetje nga ky institucion, duhet të angazhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve në Shqipëri.
17. Moduli elektronik i lejeve të punë, E-leje pune, i regjistrit elektronik për të huajt, i cili nuk është zbatuar ende për arsye teknike, duhet të zbatohet për të garantuar sigurimin e informacionit për punësimin e të huajve në vend.
18. Legjislacioni shqiptar për migracionin duhet të përmbajë dispozita për të trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë barazinë gjinore të punëtorëve migrantë.
19. Legjislacioni shqiptar për migracionin duhet të përmbajë dispozita specifike për të promovuar punësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të grave migrante në tregun e punës në Shqipëri, me qëllim ngushtimin e asimetrisë ndërmjet të drejtave të grave shqiptare dhe të drejtave të grave të huaja në Shqipëri.
20. Promovimi i pjesëmarrjes së grave migrante në tregun e punës mund të realizohet në mënyrat e mëposhtme: i) të zhvillojnë dhe zbatojnë masa të mëtejshme për të promovuar qasjen në tregun e punës dhe për të përmirësuar kushtet e punës të grave migrante; ii) grave që kanë hyrë në Shqipëri, në kuadër të bashkimit familjar duhet t'u jepet më lehtë e drejta individuale për t'u punësuar; iii) informacioni mbi ofertat e punës duhet të jetë më i lehtë për t'u marrë nëpërmjet publikimeve që synojnë gratë migrante; iv) gratë migrante jo të kualifikuara duhet të kenë më shumë qasje në arsimin profesional dhe trajnimin profesional për të fituar aftësi të reja në mënyrë që të mos kufizohen në punë të paguara jo mirë; v) diplomat, kualifikimet dhe përvoja profesionale e grave të afta dhe shumë të afta duhet të të njihen për nxitjen e pjesëmarrjes së tyre në tregun e punës; vi) grave migrante mund t'u ofrohet ndihmë për nxitjen e hapjes së SME-ve.
21. Promovimi i pjesëmarrjes së grave migrante në jetën demokratike dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre themelore mund të realizohet përmes: i) rritjes së njohurive dhe ndërgjegjësimit të tyre për të drejtat sociale në Shqipëri; ii) informimit të grave migrante për të drejtat e tyre si edhe dhe për rreziqet në shkeljen e të drejtave gjatë përvojës së tyre të punës në Shqipëri; iii) nxitjes së grave migrante për të vendosur kontakte me OJQ-të lokale, në mënyrë që të rrisin aftësitë dhe aksesin në treg; iv) informimit të grave migrante për programet e kujdesit shëndetësor dhe shërbimeve të tjera publike në vend.
22. Hendeku mes kuadrit ligjor dhe institucional në adresimin e të drejtave të punëtorëve migrantë mund të plotësohet në dy mënyra: i) institucionet ose agjencitë ekzistuese të zgjerojnë kompetencat e tyre drejt një trajtimi më të plotë të çështjeve të migrantëve në Shqipëri; ii) me anën e krijimit të institucioneve/agjencive të tjera për të adresuar në mënyrë më specifike të drejtat e punëtorëve migrantë.
23. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të trajnohen më tej për të kuptuar më mirë kontekstin dhe natyrën komplekse të veprimeve dhe shkeljet e ligjit nga qytetarët e huaj dhe punëtorët migrantë në Shqipëri.
24. Policia duhet të trajnohet më tej për të kuptuar më mirë kontekstin dhe natyrën komplekse të veprimeve dhe shkeljet e ligjit nga qytetarët e huaj dhe punëtorët migrantë në Shqipëri.

25. Duhet të përmirësohet komunikimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Kufirit dhe Migracionit me të huajt që hyjnë në mënyrë të parregullt në Shqipëri. Kjo mund të arrihet nëpërmjet rekrutimit të personelit me njohuri në gjuhë të huaja, duke ofruar kurse për këtë qëllim, ose duke punësuar persona me kohë të pjesshme, të cilët flasin këto gjuhë, sepse sigurimi i informacionit në gjuhën amtare ose në një gjuhë të kuptueshme është një e drejtë themelore dhe e rëndësishme e njeriut.
26. Personeli i shërbimeve psiko-sociale në të gjithë vendin ka nevojë për trajnime shtesë dhe të veçanta për të qenë në gjendje të trajtojnë më mirë dhe më njerëzisht të huajt dhe punëtorët migrantë, veçanërisht ata të cilëve u është privuar liria.
27. Mjekët, infermieret dhe personeli i spitalit dhe qendrave shëndetësore kanë nevojë për trajnime të veçanta, për të përmirësuar shërbimet për të huajt dhe punëtorët migrantë, duke kuptuar më mirë rreziqet e tyre përkatëse shëndetësore, përcaktuesit socialë, shëndetësore, si dhe ndikimin e kulturës shëndetësore në sëmundshmëri.
28. Punonjësit e burgjeve kanë nevojë për trajnime të veçanta për të rritur kapacitetet e tyre profesionale dhe kulturore për trajtimin e të burgosurve të huaj.
29. Duhet të shfuqizohet dispozita që kushtëzon lejen e qëndrimit për punëtorët migrantë me kërkesën që paga e tyre të jetë të paktën 150 përqind të pagës së vendasve.
30. Duhet të shfuqizohet dispozita që kushtëzon lejen e qëndrimit për studentët me kërkesën që ata të vërtetojnë me prova se kanë njohuri të gjuhën shqipe. Universitetet mund të ofrojnë mundësinë e mësimi shqip gjatë vitit të parë të studimeve.
31. Duhet të shfuqizohen dispozitat që përcaktojnë se leja e qëndrimit revokohet në rastet e divorcit nëse kjo gjë ndodh brenda 5 viteve të lëshimit të lejes së qëndrimit, dhe në rastet e vdekjes së migrantëve nëse kjo ndodh brenda 3 viteve të lëshimit të lejes së qëndrimit.
32. Duhet të shfuqizohet dispozita që përcakton se vetëm të huajt që banojnë dhe punojnë ligjërisht në Shqipëri mund të kenë marrin pjesë në integrimin social, ekonomik dhe kulturor në shoqërinë shqiptare.
33. Kushtet e veçanta për lëshimin e lejes së qëndrimit për investitorët, si:
  - i) Vlera e investimeve duhet të jetë të paktën 1 milion Euro;
  - ii) Ata duhet të punësojnë të paktën 10 punëtorë shqiptarë për të paktën 1 vit duhet të ndryshohet si më poshtë:
    - Vlera e investimeve duhet të jetë së paku 500,000 Euro;
    - Ata duhet të punësojnë të paktën 10 punëtorë shqiptarë për të paktën 3 vjet.
34. Qeveria shqiptare duhet të marrë masa për zbatimin e dispozitave të Konventës mbi pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike në nivel lokal, 1997, ratifikuar nga Shqipëria në vitin 2005, në mënyrë që të huajt që banojnë ligjërisht në Shqipëri të gëzojnë të drejtën e votës në zgjedhjet vendore.
35. Televizionet shqiptare, veçanërisht transmetuesi kombëtar dhe kanalet televizive kombëtare duhet të transmetojnë më shumë informacion dhe lajme në anglisht apo në gjuhë të tjera të huaja për të rritur aksesin e migrantëve në informacion.



# Bibliografia dhe Burimet

## *Konventat e OKB-së:*

- Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, 1990, 1998.
- Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat sociale, ekonomike dhe kulturore, 1996.
- Konventa ndërkombëtare mbi të drejtat civile dhe politike, 1966.
- Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit të grave, 1981.
- Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijëve, 1990.
- Konventa ndërkombëtare mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racor, 1969.
- Konventa mbi parandalimin dhe ndërshkrimin e krimit të genocidit, miratuar nga Rezoluta 260 (III) A e Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, datë 9 dhjetor 1948.
- Konventa e Kombeve të Bashkuara lidhur me mbi statusin e refugjatit, 1951.
- Konventa mbi Personat Pa Shtetësi, 1954 dhe Konventa mbi Reduktimin e Pashtetësisë, 1961.
- Konventa kundër torturës dhe trajtimeve apo ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore dhe poshtëruese, 1987.
- Konventa për krimin e organizuar ndërkombëtar dhe protokollet e saj, 2000.
- Protokollin shtesë kundër trafikimit të migrantëve nga toka, deti dhe ajri, 2000.

## *Konventat e ILO-s:*

- Konventa për migrimin për motive punësimi (e rishikuar), 1949 (Nr. 97) dhe rekomandimet për migrimin për motive punësimi (e rishikuar), 1949 (Nr. 86).
- Konventa për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, 1950.
- Konventa mbi punëtorët migrantë, 1975 (Nr. 143) dhe rekomandimi mbi punëtorët migrantë, 1975 (Nr. 151).
- Konventa mbi agjencitë private të punësimi, 1997 (Nr. 181).
- Konventa mbi punëtorët vendas, 2011 (Nr. 189).

## *Konventat dhe dokumentet politikë të Këshillit të Europës:*

- Konventa e këshillit të evropës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, 1950.
- Karta social evropiane (e rishikuar), 1961, 1996.
- Konventa evropiane për statusin ligjor të punëtorëve migrantë, 1977.
- Konventa kornizë e këshillit të evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, 1995.
- Konventa për pjesëmarrjen e të huajve në jetën publike, në nivel lokal, 1997.
- Konventa e këshillit të evropës mbi masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, 2005.

### **Dokumentet politike të Bashkimit Evropian:**

- Karta e të drejtave themelore e bashkimit evropian, 2000.
- Direktiva e BE-së për Barazinë Racore 2000/43/EC.
- Qasje globale ndaj migracionit dhe lëvizshmërisë, 2005.
- Direktiva e Kartës Blu, 2009.
- Direktiva për sanksionet për punëdhënësit, 2009.
- Direktiva për lejen e unifikuar, 2011.
- Direktiva për punëtorët sezonalë, 2014.
- Direktiva për transferimin brenda korporatës të punëtorëve të kualifikuar jo nga vendet e BE-së, 2014.
- Axhenda Evropiane për Migracionin, 2015.

### **Legjislacioni shqiptar:**

- Kushtetuta e Shqipërisë.
- Kodi i Punës i Shqipërisë.
- Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006, "Migrimi i shtetasve shqiptarë për qëllime punësimi".
- Ligji Nr. 10428, datë 02.06.2011, "Mbi të Drejtën Ndërkombëtare Private".
- Ligji Nr. 108/2013, "Mbi të huajt".
- Ligji Nr. 121/2014, "Azili në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 23/2015, "Shërbimi i Jashtëm".
- VKM Nr. 513, datë 13.06.2013, "Kriteret dhe procedurat e dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Shqipëri".
- VKM Nr. 265, datë 07.05.2014, "Përjashtimi nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe leje qëndrimi për shtetasit kosovarë dhe shtetasit serbë me origjinë etnike shqiptare".
- VKM Nr. 66, 67, 68, 69, 70, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85, datë 12.02.2014, "Kriteret e dokumentacionit dhe procedurat për lëshimin, refuzimin dhe revokimin e lejeve të punës".
- Udhëzimi i përbashkët Nr. 265, datë 25.05.2015, "Bashkëpunimi midis Ministrisë së Brendshme dhe Shërbimit Informativ Shtetëror mbi procedurat dhe trajtimin e të huajve që jetojnë ligjërisht në Shqipëri".
- Udhëzim Nr. 293, datë 04.06.2015, "Procedurat dhe trajtimi i të huajve që jetojnë ligjërisht në Shqipëri".
- Urdhër Nr.147, datë 09.07.2014, "Deklarimi për punësim i shtetasve të BE-së, së zonës Schengen, shtetasve të SHBA-së, Kosovës dhe shtetasve të Serbisë me përkatësi etnike shqiptare".

### **Libra, Dokumente dhe Raporte:**

- Ikonimi, L. *E drejta migratore. Material trainues (Migration law. Training manual)*, IOM, Tiranë, 2009.
- *Faktoret që influencojnë rritjen e kërkesave për azil në zonën Shengen*, Avokati i Popullit, prill 2014 (*The factors which influence the increase of Albanian asylum-seekers flows to Schengen area countries*, Albania's Ombudsman, April, 2014).
- *Konkluzione mbi monitorimin e zhvilluar në pikat kufitare në Sarandë, Gjirokastër, Korçë dhe Pogradec*, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, janar 2015 (*Conclusions on monitoring of border crossing points in Sarandë, Gjirokastër, Korçë and Pogradec*, Albanian Helsinki Committee, January 2015).

- *Më shumë vëmendje për trajtimin e emigrantëve shqiptarë në pikat e kalimit kufitar, Përfundime të vëzhgimeve të Komitetit Shqiptar të Helsinkit në pikat e kalimit kufitar, prill 2006 (More attention to the treatment of Albanian emigrants at border crossing points, Conclusions of the survey of the Albanian Helsinki Committee, April 2006).*
- *Profili i Zgjeruar i Migracionit për Shqipërinë, 2012-2014, Ministria e Punëve të Brendshme, Tiranë, 2015 (Extended Migration Profile of Albania 2012-2014, Ministry of Internal Affairs, Tirana, 2015).*
- *Raport mbi monitorimin e respektimit të të drejtave të shtetasve në pikat e kalimit kufitar, Komiteti Shqiptar i Helsinkit, shkurt 2012 (Report on monitoring of the rights of citizens at border crossing points, Albanian Helsinki Committee, February 2012).*
- *Raport Vjetor i Gjykatës së rrethit Tiranë, 2014; [www.gjykatatirana.gov.al/previewdoc.php?file\\_id=208](http://www.gjykatatirana.gov.al/previewdoc.php?file_id=208) (rigjetur në dhjetor 2015).*
- *Raport Vjetor i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, 2012; [www.gjykataelarte.gov.al/web/Publikime\\_7\\_1.php](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Publikime_7_1.php) (rigjetur në dhjetor 2015).*
- *Raport Vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministria e Drejtësisë, dhjetor 2015.*
- *Raport Vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektoratit Shtetëror të Punës, 2015.*

